

VIAC
VIAC
VIAC
VIAC
VIAC
VIAC
VIAC

RREGULLAT E
ARBITRAZHIT DHE
NDËRMJETËSIMIT TË
VIAC

VIAC
VIAC

**RREGULLAT E VJENËS,
RREGULLAT E NDËRMJETËSIMIT TË VJENËS 2021**

RREGULLAT E ARBITRAZHIT TË VIAC

RREGULLAT E VJENËS | 2021



RREGULLAT E NDËRMJETËSIMIT TË VIAC

RREGULLAT E NDËRMJETËSIMIT TË VJENËS | 2021

PJESA I



RREGULLAT E ARBITRAZHIT TË VIAC RREGULLAT E VJENËS | 2021

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

VIAC DHE VERSIONI I ZBATUESHËM I RREGULLAVE TË VJENËS

Neni 1

(1) Qendra Ndërkombëtare e Arbitrazhit në Vjenë (“VIAC”) është Institucioni i Përhershëm Ndërkombëtar i Arbitrazhit i Dhomës Ekonomike Federale Austriake¹. VIAC administron arbitrazhet vendase dhe ndërkombëtare, si dhe procedurat në përputhje me metodat e tjera alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, nëse palët kanë rënë dakord për Rregullat e Arbitrazhit të VIAC (“Rregullat e Vjenës”), Rregullat e Ndërmjetësimit të VIAC (“Rregullat e Ndërmjetësimit të Vjenës”), Rregullat e Arbitrazhit të Investimeve të VIAC (“Rregullat e Arbitrazhit të Investimeve të Vjenës”), Rregullat e Ndërmjetësimit të Investimeve të VIAC (“Rregullat e Ndërmjetësimit të Investimeve të Vjenës”); ose nëse është rënë dakord ose parashikuar që VIAC duhet të shërbejë si institucion administrues.

(2) Nëse palët nuk kanë rënë dakord ndryshe, Rregullat e Vjenës do të zbatohen sipas versionit në fuqi në kohën e fillimit të arbitrazhit (Neni 7 paragrafi 1) nëse palët, para ose pas lindjes së mosmarrëveshjes, kanë rënë dakord të paraqesin mosmarrëveshjen e tyre sipas Rregullave të Vjenës.

(3) Bordi mund të refuzojë të administrojë procedurën nëse marrëveshja e arbitrazhit devijon thellësisht nga Rregullat e Vjenës dhe nuk pajtohet me to.

BORDI

Neni 2

(1) Bordi i VIAC do të përbëhet nga të paktën pesë anëtarë. Anëtarët e Bordit do të caktohen për një mandat deri në pesë vjet nga Komiteti Kryesues i Zgjeruar i Dhomës Ekonomike Federale Austriake me rekomandimin e Presidentit të VIAC. Anëtarët mund të caktohen për mandate të njëpasnjëshme.

¹ Sipas Seksionit 139 paragrafi 2 të Statutit Federal për Dhomat Ekonomike 1998 (“Wirtschaftskammergesetz 1998”), Fletorja Zyrtare Federale I Nr. 103/1998 i ndryshuar nga Fletorja Zyrtare Federale I Nr. 27/2021

(2) Anëtarët e Bordit do të zgjedhin mes tyre një President dhe deri në dy Zëvendës Presidentë. Në rast se Presidenti pengohet të kryejë detyrat e tij, këto detyra do t'i kalojnë një Zëvendës Presidenti në përputhje me Rregullat e Brendshme të Bordit (Shtojca 2).

(3) Anëtarët e Bordit, të cilët janë ose kanë qenë të përfshirë në një arbitrazh të administruar nga VIAC në çfarëdo cilësie, nuk mund të jenë të pranishëm ose të marrin pjesë në asnjë mënyrë në diskutimet ose vendimet që kanë të bëjnë me ato procedura. Kjo nuk do të dëmtojë ekzistencën e një kuorumi të Bordit.

(4) Anëtarët e Bordit do t'i kryejnë detyrat e tyre sipas njohurive dhe aftësive të tyre më të mira dhe në kryerjen e detyrave të tyre do të jenë të pavarur dhe nuk do të marrin asnjë udhëzim. Ata kanë për detyrë të ruajnë konfidencialitetin e të gjithë informacionit të marrë gjatë kryerjes së detyrave të tyre.

(5) Bordi mund të krijojë dhe ndryshojë Rregullat e tij të Brendshme (Shtojca 2).

BORDET KËSHILLUESE

Neni 3

Bordi mund të krijojë Borde Këshilluese që ndihmojnë Bordin me kapacitet këshillimor. Bordet Këshilluese përbëhen nga ekspertë të arbitrazhit dhe/ose ndërmjetësimit të cilët mund të ftohen nga Bordi.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM, ZËVENDËS SEKRETARI I PËRGJITHSHËM DHE SEKRETARIATI

Neni 4

(1) Me rekomandimin e Bordit të VIAC, Sekretari i Përgjithshëm dhe Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i VIAC do të caktohen nga Komiteti Kryesues i Zgjeruar i Dhomës Ekonomike Federale Austriake për një mandat deri në pesë vjet. Sekretari i Përgjithshëm dhe Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm mund të caktohen për mandate të njëpasnjëshme. Pas përfundimit të mandatit, nëse nuk është bërë rinovimi i caktimit, Sekretari i Përgjithshëm dhe Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm do të qëndrojnë në detyrë derisa të bëhet një caktim i ri.

(2) Sekretariati administron çështjet administrative të VIAC nën drejtimin e Sekretarit të Përgjithshëm dhe Zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm me përjashtim të çështjeve që i rezervohen Bordit. Nëse është caktuar një Zëvendës Sekretar i Përgjithshëm, Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm mund të marrë vendime që janë në kompetencën e Sekretarit të Përgjithshëm nëse Sekretari i Përgjithshëm nuk është në gjendje të kryejë detyrat e tij, ose me autorizimin e Sekretarit të Përgjithshëm.

(3) Anëtarët e Sekretariatit, të cilët janë ose kanë qenë të përfshirë në një arbitrazh të administruar nga VIAC në çfarëdo cilësie, nuk mund të jenë të pranishëm ose të marrin pjesë në asnjë mënyrë në diskutimet ose vendimet që kanë të bëjnë me ato procedura arbitrazhi.

(4) Sekretari i Përgjithshëm dhe Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm do të kryejnë detyrat e tyre sipas njohurive dhe aftësive të tyre më të mira dhe nuk do të marrin asnjë udhëzim. Ata kanë për detyrë të ruajnë konfidencialitetin e të gjithë informacionit të marrë gjatë kryerjes së detyrave të tyre.

(5) Nëse Sekretari i Përgjithshëm dhe Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm nuk mund t'i ushtrojnë detyrat e tyre, anëtarët e Bordit caktojnë mes tyre një anëtar për kryerjen e detyrave përkatëse. Për sa kohë i caktuari shërben si Sekretar i Përgjithshëm, anëtarësimi i të caktuarit në Bord do të pezullohet.

GJUHËT E KORRESPONDENCËS

Neni 5

Korrespondenca e palëve me Bordin dhe Sekretariatin do të jetë në gjermanisht ose anglisht.

PËRKUFIZIME

Neni 6

(1) Në Rregullat e Vjenës

1.1 pala ose palët i referohen një ose më shumë paditësve, të paditurve ose një ose më shumë personave të tretë të bashkuar në arbitrazh nëpërmjet kërkesëpadisë;

1.2 paditës i referohet një ose më shumë paditësve;

1.3 i paditur i referohet një ose më shumë të paditurve;

1.4 person i tretë i referohet një ose më shumë personave të tretë, të cilët nuk janë as paditës dhe as të paditur në arbitrazhin në shqyrtim dhe të cilëve i është kërkuar të marrin pjesë në këtë arbitrazh;

1.5 gjykatë arbitrazhi i referohet një arbitri të vetëm ose një trupi gjykues prej tre arbitrash;

1.6 arbitër i referohet një ose më shumë arbitrave;

1.7 bashkë-arbitër i referohet çdo anëtar i të një trupi gjykues arbitrash përveç kryetarit;

1.8 vendim i referohet çdo vendimi të prerë, të pjesshëm ose të përkohshëm;

1.9 financimi nga personat e tretë i referohet çdo marrëveshjeje të lidhur me një individ ose person juridik që nuk është palë në një procedurë arbitrazhi ose përfaqësues pale (neni 13), për të financuar ose ofruar çdo mbështetje tjetër materiale për një palë, duke financuar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë një pjesë ose të gjitha shpenzimet e procedurës së arbitrazhit qoftë nëpërmjet një dhurimi ose një granti, ose në këmbim të shpërblimit ose rimbursimit që varet tërësisht ose pjesërisht nga rezultati i procedurës së arbitrazhit.

(2) Në masën që termat e përdorur në Rregullat e Vjenës iu referohen individëve, forma e zgjedhur do të zbatohet për të gjitha gjinitë. Në praktikë, termat në këto rregulla do të përdoren në mënyrë specifike për secilën gjini.

(3) Referencat për "nenet" pa specifikime të mëtejshme kanë të bëjnë me nenet përkatëse të Rregullave të Vjenës.

FILLIMI I ARBITRAZHIT

KËRKESËPADIA

Neni 7

(1) Procedura e arbitrazhit fillon me paraqitjen e kërkesëpadiisë. Procedura e arbitrazhit do të fillojë në datën e marrjes së kërkesëpadiisë nga Sekretariati i VIAC ose nga një Dhomë Ekonomike Rajonale Austriake në formë fizike ose në formë elektronike (Neni 12 paragrafi 1); në këtë rast, procedura quhet në shqyrtim. Sekretariati informon palët e tjera për depozitimimin e kërkesëpadiisë.

(2) Kërkesëpadiia do të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

2.1 emrat e plotë, adresat, duke përfshirë adresat e postës elektronike dhe detajet e tjera të kontaktit të palëve dhe çdo koment mbi shtetësitë e palëve;

2.2 një deklaratë të fakteve dhe kërkimin konkret të paditësit;

2.3 vlerën monetare të çdo pretendimi individual në momentin e paraqitjes së kërkesëpadiisë nëse kërkimi nuk është ekskluzivisht për një shumë të caktuar parash;

2.4 të dhënat në lidhje me numrin e arbitrave në përputhje me Nenin 17;

2.5 emërimin e një arbitri nëse vendimi për mosmarrëveshjen do të merret nga një trup gjykues prej tre arbitrash, ose një kërkesë që arbitri të caktohet nga Bordi; dhe

2.6 të dhënat në lidhje me marrëveshjen e arbitrazhit dhe përmbajtjen e saj.

(3) Nëse kërkesëpadia nuk është në përputhje me paragrafin 2 të këtij Neni, ose nëse një kopje e kërkesëpadiës ose provave mungon (Neni 12 paragrafi 1), Sekretari i Përgjithshëm mund të kërkojë që paditësi të rregullojë të metat brenda një periudhe kohore të caktuar nga Sekretari i Përgjithshëm. Nëse paditësi vepron në përputhje me urdhrin për rregullimin e të metave brenda afatit të caktuar, kërkesëpadia do të konsiderohet se është paraqitur në datën në të cilën është marrë për herë të parë. Nëse paditësi nuk vepron në përputhje me urdhrin për rregullimin e të metave brenda afatit të caktuar, Sekretari i Përgjithshëm mund të deklarojë mbarimin e procedurës (Neni 34 paragrafi 3). Kjo nuk do ta pengojë paditësin që të ngrejë të njëjtat pretendime në një kohë të mëpasshme në një procedurë tjetër arbitrazhi.

(4) Sekretari i Përgjithshëm do t'ia dërgojë kërkesëpadinë të paditurit nëse nuk është lëshuar urdhri për rregullimin e të metave sipas paragrafit 3 të këtij Neni ose nëse paditësi e ka respektuar këtë urdhër.

DEKLARATA E MBROJTJES

Neni 8

(1) Sekretari i Përgjithshëm do t'i kërkojë të paditurit që t'i paraqesë Sekretariatit deklaratën e mbrojtjes (Neni 12 paragrafi 3) brenda një periudhe prej 30 ditësh pas marrjes së kërkesëpadiës.

(2) Deklarata e mbrojtjes duhet të përmbajë informacionin në vijim:

2.1 emrin e plotë, adresën, duke përfshirë adresën e postës elektronike dhe detajet e tjera të kontaktit të të paditurit dhe çdo koment mbi shtetësitë e palëve;

2.2 komente mbi kërkimet dhe faktet mbi të cilat bazohet kërkesëpadia, si dhe prapësimet e veçanta të palës së paditur;

2.3 të dhënat në lidhje me numrin e arbitrave në përputhje me Nenin 17; dhe

2.4 emërimin e një arbitri nëse mosmarrëveshja do të vendoset nga një trup gjykues prej tre arbitrash, ose një kërkesë që arbitri të caktohet nga Bordi.

KUNDËRPADIA

Neni 9

- (1) Kërkimet e palës së paditur kundër paditësit mund të ngrihen si kundërpadi në të njëjtën procedurë arbitrazhi.
- (2) Nenet 7, 10 dhe 11 zbatohen për kundërpadi të.
- (3) Gjykata e arbitrazhit mund t'ia kthejë kundërpadinë Sekretariatit për t'u gjykuar në procedura arbitrazhi të ndara nëse:

3.1 palët nuk janë identike; ose

3.2 kundërpadia e depozituar pas deklaratës së mbrojtjes do të sillte vonesa të konsiderueshme në procedurën kryesore të arbitrazhit.

- (4) Gjykata e arbitrazhit do t'i japë paditësit mundësinë për të depozituar deklaratën e mbrojtjes ndaj kundërpadisë së pranuar për t'u marrë në shqyrtim. Neni 8 zbatohet për deklaratën e mbrojtjes ndaj kundërpadisë.

TARIFA E REGJISTRIMIT

Neni 10

- (1) Paditësi do të paguajë tarifën e regjistrimit neto në shumën e përcaktuar në Shtojcën 3 brenda afatit kohor të caktuar nga Sekretari i Përgjithshëm. Po kështu, në rastin e thirrjes së një personi të tretë (Neni 14), pala kërkuese do të paguajë një tarifë regjistrimi.
- (2) Nëse në arbitrazh janë më shumë se dy palë, tarifa e regjistrimit do të rritet me 10 për qind për secilën palë shtesë, deri në një rritje maksimale prej 50 për qind.
- (3) Tarifa e regjistrimit është e pakthyeshme. Tarifa e regjistrimit nuk do të zbritet nga pagesat e palës e cila paguan parapagim për shpenzimet.

(4) Kërkesëpadia dhe çdo kërkesë për thirrje të personit të tretë u dërgohet palëve të tjera vetëm pas kryerjes së plotë të pagesës së tarifës së regjistrimit. Sekretari i Përgjithshëm mund të japë një zgjatje të arsyeshme të afatit për pagesën e tarifës së regjistrimit. Nëse pagesa nuk kryhet brenda afatit, Sekretari i Përgjithshëm mund të pushojë procedurën e arbitrazhit (Neni 34 paragrafi 3). Kjo nuk do ta pengojë paditësin që të ngrejë të njëjtat pretendime më pas në një procedurë tjetër.

(5) Nëse procedura sipas Rregullave të Ndërmjetësimit të Vjenës fillon përpara, gjatë ose pas procedurës së arbitrazhit sipas Rregullave të Vjenës midis palëve të njëjta dhe në lidhje me të njëjtën çështje, nuk do të paguhet asnjë tarifë regjistrimi në procedurën e filluar më pas.

DËRGIMI I DOSJES

Neni 11

Sekretari i Përgjithshëm ia dërgon dosjen gjykatës së arbitrazhit nëse:

- Sekretariati ka marrë kërkesëpadinë (kundërpadinë) në përputhje me kërkesat e Nenit 7; dhe
- të gjithë anëtarët e gjykatës së arbitrazhit janë caktuar; dhe
- parapagimi për shpenzimet sipas Nenit 42 është kryer plotësisht.

KOMUNIKIMET ME SHKRIM, AFATET KOHORE DHE ASGJËSIMI I DOSJES

Neni 12

(1) Kërkesëpadia, duke përfshirë provat, dorëzohet në formë elektronike dhe fizike në numrin e kopjeve të nevojshme për t'i siguruar secilës palë një kopje.

(2) Pas dërgimit të dosjes në gjykatën e arbitrazhit, të gjitha komunikimet me shkrim dhe provat do t'i dërgohen secilës palë dhe çdo arbitri në mënyrën e përcaktuar nga gjykata e arbitrazhit. Sekretariati do të marrë të gjitha komunikimet me shkrim midis gjykatës së arbitrazhit dhe palëve, në formë elektronike.

(3) Komunikimet me shkrim dërgohen në kopje fizike me postë rekomande, letër me konfirmim marrje, shërbim postar ose në formë elektronike, ose me çdo mjet tjetër komunikimi që siguron një provë për dërgesën.

(4) Komunikimet me shkrim do të dërgohen në adresën e marrësit të cilit i dërgohen, siç është njoftuar së fundmi. Pasi një palë të ketë caktuar një përfaqësues, komunikimi me shkrim do të dërgohet në adresën e përfaqësuesit, siç është njoftuar së fundmi.

(5) Komunikimet me shkrim do të konsiderohen se janë pranuar në ditën që

5.1 marrësi ka marrë në fakt komunikimin me shkrim; ose

5.2 pranimi prezumohet nëse komunikimi me shkrim është dërguar në përputhje me paragrafët 3 dhe 4 të këtij Neni.

(6) Nëse kërkesëpapia kundër disa të paditurve nuk mund t'u dërgohet të gjithë të paditurve, me kërkesë të paditësit arbitrazhi do të veprojë vetëm kundër atyre të paditurve që iu është komunikuar kërkesëpapia. Me kërkesë të paditësit, kërkesëpapia kundër të paditurve të mbetur do të trajtohet në një procedurë tjetër.

(7) Afatet do të fillojnë të llogariten në ditën vijuese të njoftimit (paragrafi 5) të komunikimeve përkatëse me shkrim që shënon fillimin e afatit. Nëse kjo ditë është festë zyrtare ose ditë pushimi në vendin e pranimit, afati do të fillojë në ditën e ardhshme të punës. Festat zyrtare ose ditët e pushimit që bien gjatë një periudhe kohore nuk do të ndërpresin vazhdimin apo zgjasin afatin. Nëse dita e fundit e afatit është festë zyrtare ose ditë pushimi në vendin e marrjes, afati përfundon në ditën tjetër të punës.

(8) Afati për çdo komunikim me shkrim plotësohet, nëse ai dërgohet në mënyrën e përcaktuar në paragrafët 3 dhe 4 të këtij Neni në ditën e fundit të afatit. Afatet kohore mund të zgjaten kur konsiderohen se ekzistojnë arsye të mjaftueshme për një zgjatje të tillë.

(9) Pas përfundimit të procedurës (Neni 34), Sekretariati mund të asgjësojë të gjithë dosjen e çështjes, me përjashtim të vendimeve (Neni 35).

PËRFAQËSUESIT

Neni 13

Në procedurat para gjykatës së arbitrazhit, palët mund të përfaqësohen ose këshillohen nga persona të zgjedhur prej tyre. Sekretari i Përgjithshëm ose gjykata e arbitrazhit mund të kërkojnë në çdo kohë prova që përfaqësuesi është i autorizuar për të përfaqësuar palën.

FINANCIMI NGA PERSONAT E TRETË

Neni 13a

(1) Pala do të informojë për ekzistencën e çdo financimi nga një person i tretë dhe identitetin e financuesit në kërkesëpadinë e saj ose në deklaratën e mbrojtjes, ose menjëherë pas lidhjes së një marrëveshjeje financimi me një person të tretë.

(2) Nëse një palë informon për financimin nga një person i tretë përpara formimit të gjykatës së arbitrazhit, Sekretari i Përgjithshëm do të informojë cilindo arbitër të emëruar për t'u caktuar ose të caktuar tashmë për një informacion të tillë për qëllime të plotësimit të deklaratës së arbitrit (Neni 16 paragrafi 3).

THIRRJA E PERSONAVE TË TRETË DHE BASHKIMI I KËRKIMEVE

THIRRJA E PERSONAVE TË TRETË

Neni 14

(1) Për thirrjen e personave të tretë në arbitrazh, si dhe për mënyrën e kësaj thirrjeje, vendos gjykata e arbitrazhit me kërkesën e njëres prej palëve ose të një personi të tretë, pasi të dëgjojë të gjitha palët dhe personin e tretë që do të thirret si dhe pas shqyrtimit të të gjitha rrethanave përkatëse.

(2) Kërkesa për thirrje duhet të përmbajë këto të dhëna:

2.1 emrin e plotë, adresën, duke përfshirë adresën e postës elektronike dhe detajet e tjera të kontaktit të personit të tretë;

2.2 arsyet mbi të cilat bazohet kërkesa për thirrje; dhe

2.3 mënyrën e kërkuar të thirrjes së personit të tretë.

(3) Nëse kërkesa për thirrjen e personit të tretë bëhet në kërkesëpadi,

3.1 ajo do t'i dorëzohet Sekretariatit. Dispozitat e Nenit 7 dhe në vijim zbatohen për analogji. Sekretari i Përgjithshëm do t'ia njoftojë kërkesëpadinë personit të tretë që do të thirret, si dhe palëve të tjera për komente;

3.2 personi i tretë mund të marrë pjesë në formimin e gjykatës së arbitrazhit sipas Nenit 18 nëse ende nuk është caktuar arbitri; dhe

3.3 gjykata e arbitrazhit do t'ia kthejë Sekretariatit kërkesëpadinë e cila përmban një kërkesë për thirrje të një personi të tretë për t'u shqyrtuar në një procedurë arbitrazhi të ndryshme nëse gjykata e arbitrazhit refuzon, në përputhje me paragrafin 1, të pranojë kërkesën për thirrje të një personi të tretë të bërë nëpërmjet kërkesëpadiës. Në këtë rast, Bordi mund të revokojë çdo emërim ose caktim të konfirmuar të arbitrave dhe të urdhërojë rinovimin e formimit të gjykatës së arbitrazhit ose gjykatave të arbitrazhit në përputhje me Nenin 17 dhe vijues, nëse personi i tretë ka marrë pjesë në formimin e gjykatës së arbitrazhit në përputhje me paragrafin 3.2.

BASHKIMI I KËRKIMEVE

Neni 15

(1) Me kërkesën e një pale, dy ose më shumë procedura arbitrazhi mund të bashkohen nëse:

1.1 palët bien dakord për bashkimin; ose

1.2 është emëruar ose caktuar i njëjti arbitër (të njëjtët arbitra);

dhe vendi i arbitrazhit është i njëjtë.

(2) Bordi vendos për kërkesën për bashkimin e kërkimeve pasi t'i ketë dëgjuar palët dhe arbitrat e caktuar. Bordi do të marrë në konsideratë të gjitha rrethanat përkatëse në vendimin e tij, duke përfshirë përputhshmërinë e marrëveshjeve të arbitrazhit dhe fazën përkatëse të procedurës së arbitrazhit.

GJYKATA E ARBITRAZHIT

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 16

(1) Palët janë të lira të caktojnë personat që dëshirojnë t'i emërojnë për arbitra. Çdo person me aftësi të plotë juridike mund të veprojë si arbitër, me kusht që palët të mos kenë rënë dakord për ndonjë kërkesë të veçantë kualifikimi shtesë. Arbitrat kanë një marrëdhënie kontraktuale me palët dhe u ofrojnë shërbimet e tyre palëve.

(2) Arbitrat do ta përmbushin mandatin e tyre në mënyrë të pavarur nga palët, në mënyrë të paanshme dhe sipas njohurive dhe aftësive të tyre më të mira dhe nuk janë të detyruar ndaj asnjë udhëzimi. Ata kanë për detyrë të ruajnë konfidencialitetin e të gjithë informacionit të marrë gjatë kryerjes së detyrave të tyre.

(3) Një person i cili synon të pranojë caktimin si arbitër, para caktimit të tij, duhet të nënshkruajë dhe t'i dorëzojë Sekretarit të Përgjithshëm një deklaratë në formën e vënë në dispozicion nga VIAC që konfirmon (i) paanshmërinë dhe pavarësinë e tij; (ii) disponueshmërinë; (iii) kualifikimin; (iv) pranimin e detyrës; dhe (v) respektimin e Rregullave të Vjenës.

(4) Arbitri do të japë informacion nëpërmjet deklaratës me shkrim për të gjitha rrethanat që mund të shkaktojnë dyshime në lidhje me paanshmërinë, pavarësinë ose disponueshmërinë e tij ose që bien ndesh me marrëveshjen e palëve. Detyra për të dhënë informacion menjëherë për rrethana të tilla vazhdon të zbatohet gjatë të gjithë arbitrazhit.

(5) Anëtarët e Bordit mund të emërohen si arbitra nga palët ose bashkë-arbitrat, por nuk mund të caktohen si arbitra nga Bordi.

(6) Sjellja e secilit ose të gjithë arbitrave (Neni 28 paragrafi 1) mund të merret parasysh nga Sekretari i Përgjithshëm në përcaktimin e tarifave të arbitrave (Neni 44 paragrafët 2, 8 dhe 11).

FORMIMI I GJYKATËS SË ARBITRAZHIT

Neni 17

(1) Palët mund të bien dakord nëse procedura e arbitrazhit do të zhvillohet nga një arbitër i vetëm ose një trup gjykues prej tre arbitrash. Palët mund të bien dakord edhe për mënyrën e caktimit të arbitrave. Në mungesë të marrëveshjes, do të zbatohen paragrafët 2 deri 6 të këtij Neni.

(2) Në mungesë të marrëveshjes për numrin e arbitrave, Bordi do të përcaktojë nëse mosmarrëveshja do të vendoset nga arbitri i vetëm apo nga një trup gjykues prej tre arbitrash. Duke vepruar kështu, Bordi do të marrë parasysh kompleksitetin e çështjes, shumën e mosmarrëveshjes dhe interesin e palëve për një vendim të shpejtë dhe me shpenzime efektive.

(3) Nëse mosmarrëveshja duhet të zgjidhet nga një arbitër i vetëm, palët së bashku do të emërojnë një arbitër të vetëm dhe do të paraqesin emrin e arbitrit, adresën, duke përfshirë adresën e postës elektronike dhe të dhënat e tjera të kontaktit brenda 30 ditëve pas marrjes së kërkesës së Sekretarit të Përgjithshëm. Nëse një emërim i tillë nuk bëhet brenda kësaj periudhe kohore, arbitri i vetëm do të caktohet nga Bordi.

(4) Nëse mosmarrëveshja duhet të zgjidhet nga një trup gjykues prej tre arbitrash, secila palë do të emërojë një arbitër (peditësi në kërkesëpadi dhe i padituri në deklaratën e mbrojtjes). Nëse një palë nuk e bën këtë, Sekretari i Përgjithshëm do t'i kërkojë asaj palë të paraqesë emrin, adresën, duke përfshirë adresën e postës elektronike dhe të dhënat e tjera të kontaktit të të emëruarit të saj brenda 30 ditëve pas marrjes së kërkesës. Nëse emërimi nuk bëhet brenda kësaj periudhe kohore, arbitri do të caktohet nga Bordi.

(5) Nëse mosmarrëveshja do të zgjidhet nga një trup gjykues prej tre arbitrash, bashkë-arbitrat do të emërojnë bashkërisht një kryetar dhe do të paraqesin emrin, adresën, duke përfshirë adresën e postës elektronike dhe të dhënat e tjera të kontaktit brenda 30 ditëve pas marrjes së kërkesës së Sekretarit të Përgjithshëm. Nëse një emërim i tillë nuk bëhet brenda kësaj periudhe kohore, kryetari do të caktohet nga Bordi.

(6) Palët janë të detyruara të respektojnë emërimin përkatës të arbitrit pasi arbitri i emëruar të jetë konfirmuar nga Sekretari i Përgjithshëm ose Bordi (Neni 19).

FORMIMI I GJKATËS SË ARBITRAZHIT NË PROCEDURAT SHUMËPALËSHE

Neni 18

- (1) Formimi i gjykatës së arbitrazhit në procedurat shumëpalëshe do të jetë në përputhje me Nenin 17, dhe me dispozitat e mëposhtme shtesë:
- (2) Nëse mosmarrëveshja duhet të zgjidhet nga trupi gjykues i arbitrave, paditësit dhe të paditurit do të caktojnë bashkërisht një arbitër.
- (3) Pjesëmarrja e palës në emërimin e përbashkët të arbitrit nuk do të konsiderohet miratim për arbitrazh shumëpalësh. Nëse kundërshtohet pranueshmëria e një arbitrazhi shumëpalësh, gjykata e arbitrazhit do të vendosë për këtë pas kërkesës pasi të dëgjojë të gjitha palët, si dhe pasi të ketë marrë parasysh të gjitha rrethanat përkatëse.
- (4) Nëse në zbatim të paragrafit 2 të këtij Neni nuk caktohet një arbitër i përbashkët brenda afatit të caktuar, Bordi do të caktojë arbitrin për palën/palët që nuk ka/kanë përmbushur detyrimin. Në raste të jashtëzakonshme, pasi t'u jepet palëve mundësia për të komentuar, Bordi mund të revokojë caktimet e kryera tashmë dhe të caktojë bashkë-arbitra të rinj ose të gjithë arbitrat.

KONFIRMIMI I EMËRIMIT

Neni 19

- (1) Pasi të jetë emëruar arbitri, Sekretari i Përgjithshëm do të marrë deklaratat e arbitrit në zbatim të Nenit 16 paragrafët 3 dhe 4. Sekretari i Përgjithshëm do t'ua përcjellë palëve një kopje të këtyre deklaratave. Sekretari i Përgjithshëm do të konfirmojë arbitrin e emëruar nëse nuk ka dyshime në lidhje me paanësinë dhe pavarësinë e arbitrit dhe aftësinë për të ushtruar mandatin. Sekretari i Përgjithshëm do të informojë Bordin për një konfirmim të tillë në mbledhjen pasardhëse të Bordit.

(2) Nëse Sekretari i Përgjithshëm e konsideron të nevojshme, Bordi do të vendosë nëse do të konfirmojë një arbitër të emëruar. Përpara vendimit të Bordit, Sekretari i Përgjithshëm mund të kërkojë që të konfirmohen komentet nga arbitri dhe nga palët. Të gjitha komentet do t'u komunikohen palëve dhe arbitrit.

(3) Pas konfirmimit, arbitri i zgjedhur do të konsiderohet i caktuar.

(4) Nëse Sekretari i Përgjithshëm ose Bordi refuzojnë të konfirmojnë arbitrin e emëruar, Sekretari i Përgjithshëm do të kërkojë nga pala/palët që ka/kanë të drejtë të emërojnë arbitrin, ose nga bashkë arbitrat të emërojnë një arbitër apo kryetar tjetër brenda 30 ditëve. Nenet 16 deri në 18 do të zbatohen në mënyrë analogjike. Nëse Sekretari i Përgjithshëm ose Bordi nuk e konfirmojnë arbitrin e sapo emëruar, e drejta për të emëruar do të shuhet dhe Bordi do të caktojë arbitrin.

KUNDËRSHTIMI I ARBITRAVE

Neni 20

(1) Pas caktimit të tij, arbitri mund të kundërshtohet vetëm nëse ekzistojnë rrethana nga ku lindin dyshime të justifikueshme për paanësinë ose pavarësinë e tij, ose nëse arbitri nuk i përmbush kualifikimet e rëna dakord nga palët. Pala mund të kundërshtojë arbitrin e emëruar prej saj, ose në emërimin e të cilit ka marrë pjesë, vetëm për arsyet për të cilat pala është vënë në dijeni pas emërimit ose pjesëmarrjes së saj në emërimin e tij.

(2) Kundërshtimi i njëres palë për arbitrin e caktuar do t'i dorëzohet Sekretariatit brenda 15 ditëve nga data kur pala që kundërshton është vënë në dijeni për arsyet e kundërshtimit. Kundërshtimi do të specifikojë arsyet dhe përfshijë materiale mbështetëse për ta vërtetuar atë.

(3) Nëse arbitri i kundërshtuar nuk jep dorëheqjen, Bordi do të vendosë për kundërshtimin. Përpara se Bordi të marrë një vendim, Sekretari i Përgjithshëm do të kërkojë komente nga arbitri i kundërshtuar dhe nga pala/palët e tjera. Sekretari i Përgjithshëm mund të kërkojë komente edhe nga persona të tjerë. Të gjithë komentet do t'u komunikohen palëve dhe arbitrave.

(4) Gjykata e arbitrazhit, duke përfshirë arbitrin e kundërshtuar, mund të vazhdojë arbitrazhin ndërkohë që nuk është vendosur për kundërshtimin. Gjykata e arbitrazhit nuk mund të japë vendim deri kur Bordi të ketë vendosur për kundërshtimin.

PËRFUNDIMI I PARAKOHSHËM I MANDATIT TË ARBITRIT

Neni 21

(1) Mandati i arbitrit përfundon para kohe nëse:

1.1 palët bien dakord; ose

1.2 arbitri jep dorëheqjen; ose

1.3 arbitri vdes; ose

1.4 kërkesa për kundërshtimin e arbitrit pranohet; ose

1.5 arbitri shkarkohet nga detyra nga Bordi.

(2) Secila palë mund të kërkojë që arbitri të shkarkohet nga detyra nëse arbitri pengohet të kryejë detyrat e tij për një kohë më të gjatë se përkohësisht ose nuk i kryen detyrat e tij, duke përfshirë edhe detyrën për të vazhduar pa ndonjë vonesë të panevojshme. Pala ia paraqet kërkesën Sekretariatit. Nëse Bordi kupton se çdo paaftësi nuk është thjesht e përkohshme, ose arbitri nuk po i kryen detyrat e tij, Bordi mund ta shkarkojë arbitrin nga detyra edhe pa kërkesën e një pale. Bordi do të vendosë për largimin pasi t'u japë palëve dhe arbitrit të prekur mundësinë për të dhënë komente.

EFEKTET E PËRFUNDIMIT TË PARAKOHSHËM TË MANDATIT TË ARBITRIT

Neni 22

(1) Nëse arbitrit i përfundon mandati përpara kohe (Neni 21), arbitri do të zëvendësohet. Caktimi i një arbitri zëvendësues do të bëhet në përputhje me procedurën e caktimit të pranuar nga palët. Në mungesë të një marrëveshjeje të tillë, Sekretari i Përgjithshëm do t'i kërkojë

1.1 palëve, në rastin e një arbitri të vetëm; ose,

1.2 bashkë-arbitrave të mbetur, në rastin e kryetarit të një gjykate arbitrazhi; ose,

1.3 palës propozuese ose palës për llogari të së cilës është caktuar arbitri, kur arbitri është emëruar nga një palë ose është caktuar për llogari të një pale;

të emërojë një arbitër zëvendësues brenda 30 ditëve – në rastet e trajtuara në paragrafët 1.1 dhe 1.2 bashkërisht të këtij Neni - dhe të paraqesë emrin e të emëruarit, adresën, duke përfshirë adresën e postës elektronike dhe të dhëna e tjera të kontaktit. Nenet 16 deri 18 zbatohen për analogji. Nëse një emërim i tillë nuk bëhet brenda kësaj periudhe kohore, Bordi do të caktojë arbitrin zëvendësues. Nëse arbitri zëvendësues kundërshtohet me sukses (Neni 21 paragrafi 1.4), e drejta për të emëruar një arbitër zëvendësues përfundon dhe Bordi do të caktojë arbitrin zëvendësues.

(2) Nëse mandati i arbitrit përfundon para kohe në përputhje me Nenin 21, gjykata e re e arbitrazhit, pasi të kërkojë komentet e palëve, do të vendosë nëse dhe në çfarë mase do të përsëriten fazat e mëparshme të arbitrazhit.

(3) Shpenzimet e lidhura me përfundimin e parakohshëm të mandatit të arbitrit dhe caktimit të arbitrit zëvendësues do të bazohen në Nenin 42 paragrafi 12 dhe Nenin 44 paragrafi 11.

KUNDËRSHTIMI I EKSPERTËVE

KUNDËRSHTIMI I EKSPERTËVE

Neni 23

Neni 20 paragrafët 1 dhe 2 do të zbatohen në mënyrë analogjike për kundërshtimin e ekspertëve të caktuar nga gjykata e arbitrazhit. Gjykata e arbitrazhit do të vendosë për kundërshtimin.

JURISDIKSIONI I GJYKATËS SË ARBITRAZHIT

JURISDIKSIONI I GJYKATËS SË ARBITRAZHIT

Neni 24

(1) Kërkesa që gjykata e arbitrazhit nuk ka juridiksion do të ngrihet jo më vonë se paraqitja e parë e parashtrimeve për themelin e çështjes. Një palë nuk përjashtohet nga ngritja e një kundërshtimi të tillë nga fakti se ajo ka emëruar një arbitër në përputhje me Nenin 17 ose ka marrë pjesë në emërimin e një arbitri në përputhje me Nenin 18. Një kundërshtim që gjykata e arbitrazhit po e tejkalon objektin e autoritetit të saj do të ngrihet sapo çështja që pretendohet se tejkalon objektin e autoritetit të saj, të ngrihet gjatë arbitrazhit. Një kundërshtim i mëvonshëm do të ndalohet në të dyja rastet; megjithatë, nëse gjykata e arbitrazhit konsideron se vonesa është e justifikuar mjaftueshëm, ajo mund të pranojë një kundërshtim të mëvonshëm.

(2) Gjykata e arbitrazhit vendos për juridiksionin e saj. Vendimi për juridiksionin mund të merret së bashku me vendimin përfundimtar ose me një vendim të veçantë. Kur gjykata e arbitrazhit konstaton mungesën e juridiksionit, ajo me kërkesë të njëjës prej palëve, do të vendosë për detyrimet e palëve për shpenzimet.

PROCEDURA PËRPARA GJYKATËS SË ARBITRAZHIT

VENDI I ARBITRAZHIT

Neni 25

(1) Palët janë të lira të bien dakord për vendin e arbitrazhit. Në mungesë të marrëveshjes së palëve, vendi i arbitrazhit do të jetë Vjena.

(2) Gjykata e arbitrazhit mund të shqyrtojë ose të ndërmarrë veprime procedurale në çdo vend që e sheh të përshtatshëm, pa ndryshuar vendin e arbitrazhit.

GJUHA E ARBITRAZHIT

Neni 26

Në mungesë të marrëveshjes së palëve për gjuhën(t) e arbitrazhit, menjëherë pas dërgimit të dosjes, gjykata e arbitrazhit do të përcaktojë gjuhën(t) duke pasur parasysh të gjitha rrethanat, duke përfshirë dhe gjuhën e kontratës.

LIGJI I ZBATUESHËM, AMIABLE COMPOSITEUR

Neni 27

(1) Gjykata e arbitrazhit vendos për mosmarrëveshjen në përputhje me ligjin ose rregullat ligjore për të cilat palët kanë rënë dakord. Me përjashtim të rasteve kur palët kanë rënë dakord shprehimisht ndryshe, çdo marrëveshje në lidhje me një ligj të caktuar shtetëror ose sistem ligjor shtetëror do të interpretohet si një referencë e drejtpërdrejtë ndaj atij ligji shtetëror material dhe jo ndaj rregullave shtetërore të konfliktit të ligjeve.

(2) Nëse palët nuk e kanë përcaktuar ligjin ose rregullat ligjore të zbatueshme, gjykata e arbitrazhit do të zbatojë ligjin ose rregullat ligjore të cilat i konsideron të përshtatshme.

(3) Gjykata e arbitrazhit do të vendosë *ex aequo et bono* ose si *amiable compositeur* vetëm në rastet kur palët e kanë autorizuar shprehimisht për ta bërë këtë.

ZHVILLIMI I ARBITRAZHIT

Neni 28

(1) Gjykata e arbitrazhit do ta zhvillojë arbitrazhin në përputhje me rregullat e Vjenës dhe marrëveshjen e palëve në mënyrë efikase dhe me shpenzime efektive, por në çdo rast sipas diskrecionit të saj. Gjykata e arbitrazhit do t'i trajtojë palët në mënyrë të drejtë. Palëve u jepet e drejta për t'u dëgjuar në çdo fazë të procedurës.

(2) Pas njoftimit paraprak, gjykata e arbitrazhit, ndër të tjera, mund të marrë parasysh kërkesat, paraqitjen e provave dhe kërkesat për sigurimin e provave të pranueshme vetëm deri në një moment të caktuar kohor të procedurës.

(3) Në çdo fazë të procedurës, gjykata e arbitrazhit ka të drejtë të lehtësojë përpjekjet e palëve për të arritur një zgjidhje me pajtim.

PËRCAKTIMI I FAKTEVE TË ÇËSHTJES

Neni 29

(1) Nëse gjykata e arbitrazhit e konsideron të nevojshme, me iniciativën e saj ajo mund të mbledhë prova, të pyesë palët ose dëshmitarët, të kërkojë nga palët të paraqesin prova dhe të thërrasë ekspertë. Neni 43 do të zbatohet nëse kryhen shpenzime si rezultat i sigurimit të provave dhe, në veçanti, caktimit të ekspertëve.

(2) Arbitrazhi do të vazhdojë pavarësisht dështimit të ndonjërës prej palëve për të marrë pjesë në të.

SEANCA DËGJIMORE

Neni 30

(1) Përveç nëse palët nuk bien dakord ndryshe, gjykata e arbitrazhit vendos nëse procedura duhet të zhvillohet verbalisht ose me shkrim. Nëse palët nuk e kanë përjashtuar një seancë dëgjimore, me kërkesë të cilësdo palë, gjykata e arbitrazhit do të mbajë një seancë të tillë në një fazë të përshtatshme të procedurës. Duke pasur parasysh pikëpamjet e palëve dhe rrethanat specifike të çështjes, gjykata e arbitrazhit mund të vendosë të mbajë një seancë dëgjimore fizikisht ose me mjete të tjera. Palët do të kenë mundësinë në çdo rast të pranojnë dhe shprehen mbi kërkesat dhe pretendimet e palëve të tjera dhe mbi rezultatin e procedurës së paraqitjes të provave.

(2) Data e seancës dëgjimore do të caktohet nga arbitri i vetëm ose kryetari. Seancat dëgjimore nuk do të jenë të hapura për publikun. Arbitri i vetëm ose kryetari do të përgatisë dhe nënshkruajë procesverbalin e seancës, i cili duhet të përmbajë të paktën një përmbledhje të seancës dëgjimore dhe rezultateve të saj.

DETYRIMI PËR TË KUNDËRSHTUAR

Neni 31

Nëse një palë është në dijeni të një shkeljeje nga gjykata e arbitrazhit të një dispozite të Rregullave të Vjenës ose dispozitave të tjera të zbatueshme për procedurën e arbitrazhit, ajo duhet të paraqesë menjëherë një kundërshtim në gjykatën e arbitrazhit, dhe në rast të mosparaqitjes pala do të konsiderohet se ka hequr dorë nga e drejta e saj për të kundërshtuar.

MBYLLJA E PROCEDURAVE DHE KOHA PËR DHËNIEN E VENDIMIT

Neni 32

(1) Sapo gjykata e arbitrazhit të bindet se palët kanë pasur mundësi të mjaftueshme për të bërë parashtrime dhe për të ofruar prova, gjykata e arbitrazhit do ta shpallë procedurën të mbyllur për çështjet për të cilat do të jepet vendimi. Gjykata e arbitrazhit mund të rihapë procedurën në çdo kohë.

(2) Vendimi do të jepet jo më vonë se tre muaj pas seancës së fundit lidhur me çështjet për të cilat jepet vendimi ose depozimit të pretendimeve përfundimtare të autorizuar për çështje të tilla, cilado ndodh më vonë. Sekretari i Përgjithshëm mund të zgjasë afatin në bazë të një kërkesë të arsyetuar nga gjykata e arbitrazhit ose me nismën e tij. Tejkalimi i afatit kohor për vendimin nuk do ta bëjë të pavlefshme marrëveshjen e arbitrazhit ose nuk do t'i heqë juridiksionin gjykatës së arbitrazhit.

MASAT E NDËRMJETME OSE KONSERVATIVE TË SIGURIMIT TË PADISË/GARANCIA PËR SHPENZIMET

Neni 33

(1) Përveç rastit kur palët kanë rënë dakord ndryshe, sapo dosja t'i dërgohet gjykatës së arbitrazhit (Neni 11), gjykata e arbitrazhit, me kërkesën e një pale, mund të urdhërojë masa të ndërmjetme ose konservative të sigurimit të padisë kundër një pale tjetër, si dhe të ndryshojë, pezullojë ose revokojë çdo masë të tillë. Palët e tjera do të dëgohen përpara se gjykata e arbitrazhit të marrë ndonjë vendim për masat e ndërmjetme ose konservative të sigurimit të padisë. Gjykata e arbitrazhit mund të kërkojë nga çdo palë të ofrojë garanci të përshtatshme në lidhje me një masë të tillë. Palët do t'i zbatojnë këto urdhra, pavarësisht nëse ato janë të ekzekutueshme përpara gjykatave shtetërore.

(2) Çdo urdhër për masa të ndërmjetme ose konservative të sigurimit të padisë sipas këtij Neni jepet me shkrim. Në një arbitrazh me më shumë se një arbitër, do të jetë i mjaftueshëm nënshkrimi i kryetarit. Nëse kryetari pengohet të veprojë, mjafton nënshkrimi i një arbitri tjetër, me kusht që arbitri që nënshkruan urdhrin të japë arsyet e mungesës së nënshkrimit të kryetarit.

(3) Nëse palët nuk kanë rënë dakord ndryshe, urdhrat për masat e ndërmjetme ose të sigurimit të padisë duhet të paraqesin arsyet në të cilat ato bazohen. Urdhri do të identifikojë datën në të cilën është lëshuar dhe vendin e arbitrazhit.

(4) Urdhrat për masat e ndërmjetme ose të sigurimit të padisë mbahen në të njëjtën mënyrë si edhe vendimet përfundimtare (Neni 36 paragrafi 5).

(5) Dispozitat e paragrafëve 1 deri në 4 të këtij Neni nuk i pengojnë palët që të kërkojnë pranë ndonjë autoriteti shtetëror kompetent masa të ndërmjetme ose konservative të sigurimit të padisë. Kërkesa drejtuar një autoriteti shtetëror për të urdhëruar masa të tilla ose për të zbatuar masa të tilla të urdhëruara tashmë nga gjykata e arbitrazhit nuk do të përbëjë shkelje ose heqje dorë nga marrëveshja e arbitrazhit dhe nuk do të ndikojë në kompetencat e gjykatës së arbitrazhit. Palët do të informojnë menjëherë Sekretariatin dhe gjykatën e arbitrazhit për çdo kërkesë të tillë, si dhe për të gjitha masat e urdhëruara nga autoriteti shtetëror.

(6) Gjykata e arbitrazhit, me kërkesën e një pale, mund të urdhërojë çdo palë që paraqet një kërkesëpadi ose kundërkërpadit që të ofrojë garanci për shpenzimet, nëse pala kërkuese paraqet arsye se rikuperimi i një kërkesë të mundshme për shpenzimet ka një nivel të mjaftueshëm probabiliteti që të jetë në rrezik. Kur vendos për një kërkesë për garancinë e shpenzimeve, gjykata e arbitrazhit do t'u japë mundësinë të gjitha palëve që të paraqesin pikëpamjet e tyre.

(7) Nëse një palë nuk respekton urdhrin e gjykatës së arbitrazhit për garancinë e shpenzimeve, gjykata e arbitrazhit, sipas kërkesës, mund ta pezullojë plotësisht ose pjesërisht ose ta ndërpresë procedurën e arbitrazhit (Neni 34 paragrafi 2.4).

MËNYRAT E PËRFUNDIMIT TË PROCEDURËS SË ARBITRAZHIT

Neni 34

Procedura e arbitrazhit përfundon:

(1) me dhënien e vendimit përfundimtar (Nenet 36 dhe 37 paragrafi 1); ose

(2) me urdhër të gjykatës së arbitrazhit, nëse

2.1 paditësi tërheq kërkesëpadinë e tij, përveç nëse i padituri kundërshton dhe ekziston një interes legjitim i palës së paditur për të marrë një zgjidhje përfundimtare të mosmarrëveshjes;

2.2 palët bien dakord për përfundimin e arbitrazhit dhe ia komunikojnë këtë marrëveshje gjykatës së arbitrazhit dhe Sekretarit të Përgjithshëm;

2.3 vazhdimi i procedurës është bërë i pamundur, veçanërisht për shkak se palët në arbitrazh nuk e ndjekin më tej arbitrazhin pavarësisht një urdhri me shkrim nga gjykata e arbitrazhit, i cili i referohet mundësisë së përfundimit të arbitrazhit;

2.4 pala nuk respekton urdhrin e gjykatës së arbitrazhit për pagimin e garancisë së shpenzimeve (Neni 33 paragrafi 7); ose

(3) me një deklaratë të Sekretarit të Përgjithshëm

3.1 për mospërbushje të urdhrit për rregullimin e të metave (Neni 7 paragrafi 3) ose për kryerjen e pagesës (Neni 10 paragrafi 4 dhe Neni 42 paragrafët 11 dhe 12);

3.2 në rastin e paragrafëve 2.1 deri në 2.3 nëse dosja nuk është dërguar ende në gjykatën e arbitrazhit.

VENDIMET E GJYKATËS SË ARBITRAZHIT

Neni 35

(1) Çdo vendim dhe çdo vendim tjetër i gjykatës së arbitrazhit kërkon miratimin e shumicës së anëtarëve të trupit gjykues. Nëse arbitrat nuk mund të formojnë shumicën, do të vendosë kryetari.

(2) Kryetari mund të vendosë i vetëm për çështje procedurale nëse autorizohet nga bashkë-arbitrat.

VENDIMI I ARBITRAZHIT

Neni 36

(1) Vendimet duhet të jenë me shkrim. Vendimet duhet të jenë të arsyetuara me përjashtim të rasteve kur palët kanë rënë dakord me shkrim ose gjatë seancave dëgjimore që në përmbajtjen e vendimit të mos paraqitet arsyetimi.

(2) Vendimi duhet të përmbajë datën e shpalljes dhe vendin e arbitrazhit (Neni 25).

(3) Të gjitha kopjet origjinale të vendimit duhet të nënshkruhen nga arbitrat. Nënshkrimi i shumicës së arbitrave do të mjaftojë në rastin kur njëri prej tyre refuzon të nënshkruajë ose nuk mund të nënshkruajë për shkak të një rrethane penguese e cila nuk kapërcehet brenda një afati të arsyeshëm. Nëse vendimi është marrë me shumicë votash dhe jo unanim, kjo duhet të pasqyrohet me kërkesë të arbitrit të pakicës.

(4) Të gjitha kopjet origjinale të vendimit do të nënshkruhen nga Sekretari i Përgjithshëm dhe do të mbajnë vulën e VIAC, e cila provon se është një vendim i VIAC, i marrë dhe i nënshkruar nga një ose më shumë arbitra të caktuar sipas Rregullave të Vjenës.

(5) Sekretari i Përgjithshëm do t'i dërgojë palëve kopje fizike të vendimit. Nëse kopjet fizike të vendimit nuk mund të dërgohen brenda një kohe të arsyeshme, apo nëse palët kanë rënë dakord, Sekretariati mund t'i komunikojë vendimin palëve në formë elektronike. Në këtë rast, kopja fizike e vendimit mund të dërgohet në një moment kohor të mëvonshëm. Për këto qëllime, zbatohet Neni 12, paragrafët 3,4 dhe 5. Sekretariati do të mbajë një kopje origjinale të vendimit dhe dokumentacionin që provon dërgesën.

(6) Me kërkesë të njëres prej palëve, arbitri i vetëm ose kryetari (ose në rast se këtij të fundit i ndalohet, një arbitër tjetër) ose, kur këtyre nuk u lejohet, Sekretari i Përgjithshëm do të konfirmojë në të gjitha kopjet origjinale të vendimit, se ai është përfundimtar dhe i zbatueshëm.

(7) Duke pranuar Rregullat e Vjenës, palët marrin përsipër të respektojnë vendimin.

VENDIMI I ARRITUR NËPËRMJET ZGJIDHJES ME MIRËKUPTIM TË MOSMARRËVESHJES

Neni 37

(1) Me kërkesën e palëve, gjykata e arbitrazhit mund të marrë një vendim (Neni 36) mbi bazën e kushteve për të cilat palët kanë rënë dakord dhe të cilat pasqyrojnë marrëveshjen e arritur mes tyre.

(2) Palët mund të kërkojnë që përmbajtja e marrëveshjes së arritur mes tyre të regjistrohet nga gjykata e arbitrazhit. Në këtë rast, procedura e arbitrazhit përfundon në përputhje me Nenin 34 paragrafi 2.2.

VENDIMI MBI SHPENZIMET

Neni 38

(1) Në përfundim të procedurës së arbitrazhit, me kërkesë të njëres prej palëve, gjykata e arbitrazhit do të përcaktojë, në vendimin përfundimtar ose nëpërmjet një vendimi të veçantë, shpenzimet e arbitrazhit që përlllogariten nga Sekretari i Përgjithshëm sipas Nenit 44 paragrafi 1.1, vlerën e shpenzimeve të palëve për procedurën e arbitrazhit sipas Nenit 44 paragrafi 1.2 si dhe shpenzime të tjera shtesë sipas Nenit 44 paragrafi 1.3.

(2) Gjykata e arbitrazhit vendos gjithashtu se cilës palë do t'i ngarkohen shpenzimet ose mënyrën se si do të ndahen shpenzimet ndërmjet palëve. Përveç rastit kur palët kanë rënë dakord ndryshe, gjykata e arbitrazhit do të vendosë për ndarjen e shpenzimeve sipas diskretonit të saj. Sjellja e palës ose palëve dhe përfaqësuesve të tyre (Neni 13), si dhe në veçanti sjellja e tyre kundrejt zhvillimit të procedurës së arbitrazhit në mënyrë dhe me shpenzime efektive, mund të merren në konsideratë nga gjykata e arbitrazhit për vendimin e saj për shpenzimet sipas këtij Neni.

(3) Pavarësisht paragrafit 1 dhe 2, më kërkesë të njëres prej palëve, gjykata e arbitrazhit mund të vendosë në çdo fazë të procedurës së arbitrazhit në lidhje me shpenzimet sipas Nenit 44 paragrafi 1.2 dhe 1.3 si dhe të kërkojë pagimin e tyre.

KORRIGJIMI, SAKTËSIMI DHE PLOTËSIMI I VENDIMIT TË ARBITRAZHIT

Neni 39

(1) Brenda 30 ditëve nga marrja e vendimit, secila palë mund të depozitojë pranë Sekretariatit kërkesat e mëposhtme për gjykatën e arbitrazhit:

1.1 për të korrigjuar çdo gabim në përlllogaritje, gabime ortografike, gabime në shtypshkrim ose gabime të tjera të kësaj natyre;

1.2 për të qartësuar pjesë të vendimit;

1.3 për të marrë një vendim shtesë në lidhje me pretendimet e paraqitura në arbitrazh por që nuk janë zgjidhur në vendim.

(2) Gjykata e arbitrazhit do të vendosë për këtë kërkesë. Gjykata e arbitrazhit dëgjon palët e tjera para se të marrë vendimin. Gjykata e arbitrazhit cakton një afat për komente jo më të gjatë se 30 ditë. Sekretari i Përgjithshëm mund të kërkojë një garanci paraprake për të mbuluar shpenzimet shtesë të gjykatës dhe shpenzimet administrative (Neni 42 paragrafi 12). Tarifat shtesë të arbitrave si dhe tarifat shtesë administrative përcaktohen nga Sekretari i Përgjithshëm sipas diskrecionit të tij.

(3) Brenda 30 ditëve nga data e dhënies së vendimit, gjykata kryesisht mund të korrigjojë gabimet sipas paragrafit 1.1 apo të plotësojë vendimin fillestar sipas paragrafit 1.3 të këtij Neni.

(4) Neni 36 zbatohet në rastin e plotësimit të vendimit. Korrigjimet dhe qartësimet do të jepen në formën e një shtojce e cila do të jetë pjesë përbërëse e vendimit të arbitrazhit.

KTHIMI I ÇËSHTJES GJYKATËS SË ARBITRAZHIT

Neni 40

Kur një gjykatë shtetërore ia kthen shqyrtimin e një mosmarrëveshjeje gjykatës së arbitrazhit, do të zbatohen me analogji dispozitat e Rregullave të Vjenës mbi procedurat e arbitrazhit. Sekretari i Përgjithshëm dhe Bordi mund të marrin çdo masë të nevojshme për t'i mundësuar gjykatës së arbitrazhit përmbushjen e kërkesave të kthimit. Sekretari i Përgjithshëm mund të përcaktojë një paradhënie mbi shpenzimet e nevojshme për të mbuluar tarifin shtesë të gjykatës së arbitrazhit dhe tarifin administrative (Neni 42 paragrafi 12). Tarifin shtesë të arbitrave dhe tarifin shtesë administrative përcaktohen nga Sekretari i Përgjithshëm sipas diskrecionit të tij.

PUBLIKIMI I VENDIMEVE

Neni 41

Bordi dhe Sekretari i Përgjithshëm mund të publikojnë përmbledhje të anonimizuar ose ekstrakte të vendimeve në revista ligjore ose në publikimet e vetë VIAC, përveç rastit kur një palë ka kundërshtuar publikimin brenda 30 ditëve nga marrja e vendimit.

SHPENZIMET

PARADHËNIA PËR SHPENZIMET

Neni 42

- (1)** Sekretari i Përgjithshëm do të caktojë vlerën e paradhënies për shpenzimet në lidhje me tarifat e ardhshme administrative të VIAC, tarifat e ardhshme të arbitrave dhe shpenzimet e mundshme, duke përfshirë tatimin mbi vlerën e shtuar të zbatueshëm, veçmas për paditë dhe kundërpaditë.
- (2)** Kërkesat e ngritura mbi bazën e kompensimit (Neni 44 paragrafi 6) – për qëllime të llogaritjes së paradhënies për shpenzimet – do të trajtohen si kërkesa të veçanta për sa kohë që këto pretendime mund të kërkojnë që gjykata e arbitrazhit të angazhohet në shqyrtimin e çështjeve shtesë.
- (3)** Për kërkesat e personave të tretë (Neni 14), Sekretari i Përgjithshëm mund të caktojë paradhënie të veçanta për shpenzimet (paragrafi 1) duke pasur parasysh rrethanat e çështjes.
- (4)** Paradhënia për shpenzimet do të paguhet në pjesë të barabarta nga palët përpara dërgimit të dosjes në gjykatën e arbitrazhit brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës për pagesë.
- (5)** Në procedurën shumëpalëshe, gjysma e paradhënies për shpenzimet do të paguhet nga paditësit dhe gjysma tjetër do të paguhet nga të paditurit, përveç nëse përcaktohet ndryshe nga Sekretari i Përgjithshëm duke pasur parasysh rrethanat e çështjes.
- (6)** Kur paraqiten kundërpadi ose pretendime mbi bazën e kompensimit dhe caktohen paradhënie të veçanta për shpenzimet, Sekretari i Përgjithshëm mund të vendosë që secila palë të paguajë paradhënien për shpenzimet që korrespondojnë me pretendimet e saj.

(7) Kur Sekretari i Përgjithshëm ka caktuar më parë paradhënie për shpenzimet në përputhje me parashikimet e paragrafëve 1 deri 3, këto do të zëvendësohen me paradhëniet e caktuara në përputhje me paragrafët 5 dhe 6 dhe shuma e çdo paradhënieje të paguar më parë nga cilado palë do të kreditohet në pjesën e saj të paradhënieve, siç përcaktohet nga Sekretari i Përgjithshëm në përputhje me paragrafët 5 dhe 6.

(8) Duke rënë dakord me Rregullat e Vjenës, palët angazhohen reciprokisht të shlyejnë pjesën e tyre përkatëse të paradhënies për shpenzimet në përputhje me këtë Nen.

(9) Nëse paradhënia për shpenzimet që i ngarkohen një pale nuk paguhet ose nuk paguhet plotësisht brenda afatit kohor të specifikuar, Sekretari i Përgjithshëm do të informojë palën/palët tjetër dhe do të kërkojë pagesën e shumës së papaguar brenda 30 ditëve pas marrjes së njoftimit. Kjo nuk do të ndikojë në detyrimin e palës që nuk paguan pjesën e saj të paradhënies për shpenzimet sipas këtij Neni.

(10) Nëse një palë nuk përmbush pjesën e saj të detyrimeve të pagesës sipas këtij Neni, dhe nëse pala/palët tjetër paguan pjesën përkatëse sipas paragrafit 9 të këtij Neni, me kërkesën e palës/palëve që paguajnë dhe për aq sa konstaton se ka juridiksion mbi mosmarrëveshjen, gjykata e arbitrazhit mund të urdhërojë palën që nuk ka kryer pagesën, nëpërmjet një vendimi ose një forme tjetër të përshtatshme, që t'i rimburojë palës/palëve paguese pjesën që i takon kësaj të fundit. Kjo nuk do të ndikojë në autoritetin dhe detyrimin e gjykatës së arbitrazhit për të përcaktuar ndarjen përfundimtare të shpenzimeve në përputhje me Nenin 38.

(11) Në parim, gjykata e arbitrazhit shqyrton vetëm kërkesëpaditë ose kundërpaditë, për të cilat është paguar plotësisht paradhënia për shpenzimet. Nëse pagesa nuk bëhet brenda afatit të caktuar nga Sekretari i Përgjithshëm, gjykata e arbitrazhit mund të pezullojë procedurën e arbitrazhit tërësisht ose pjesërisht, ose Sekretari i Përgjithshëm mund të përfundojë procedurën e arbitrazhit (Neni 34 paragrafi 3) në lidhje me pretendimet përkatëse. Kjo nuk i pengon palët të ngrenë të njëjtat pretendime në një kohë të mëvonshme në një procedurë tjetër.

(12) Nëse një shtesë në paradhënien për shpenzimet është e nevojshme dhe përcaktohet në përputhje me rrethanat nga Sekretari i Përgjithshëm, do të zbatohet procedura e përshkruar në paragrafët 1 deri 11 të këtij Neni. Deri në pagesën e paradhënies shtesë për shpenzimet, në parim, gjykata e arbitrazhit nuk do të trajtojë pretendimet që sollën rritje ose paradhënie shtesë për shpenzimet. Nëse pagesa nuk bëhet brenda afatit të caktuar nga Sekretari i Përgjithshëm, gjykata e arbitrazhit mund të pezullojë procedurën e arbitrazhit tërësisht ose pjesërisht, ose Sekretari i Përgjithshëm mund të përfundojë procedurën e arbitrazhit (Neni 34 paragrafi 3).

PARADHËNIA PËR SHPENZIMET SHITESË PROCEDURALE

Neni 43

(1) Nëse gjykata e arbitrazhit i konsideron të nevojshëm disa hapa proceduralë që ndikojnë në vlerën e shpenzimeve, të tilla si caktimi i ekspertëve, interpretëve ose përkthyesve, një transkriptim fjalë për fjalë i procedurës së arbitrazhit, një vizitë në vend ose ndryshim i vendit ku mbahet seanca, atëherë gjykata e arbitrazhit do të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm dhe do të organizojë mbulimin e këtyre shpenzimeve të mundshme.

(2) Gjukata e arbitrazhit mund të ndërmarrë hapat proceduralë të parashikuar në paragrafin 1 të këtij Neni vetëm pasi shpenzimet e mundshme të jenë mbuluar mjaftueshëm.

(3) Gjukata e arbitrazhit do të vendosë se cilat pasoja do të lindin për procedurën, nëse ka, nga mospagimi i paradhënies së kërkuar për shpenzimet sipas këtij Neni.

(4) Të gjitha vendimet në lidhje me hapat proceduralë të parashikuar në paragrafin 1 të këtij Neni do të merren nga gjykata e arbitrazhit për llogari të palëve.

PËRBËRJA DHE LLOGARITJA E SHPENZIMEVE PROCEDURALE

Neni 44

(1) Shpenzimet e arbitrazhit përbëhen nga:

1.1 tarifat administrative të VIAC, tarifat dhe shpenzimet e arsyeshme të arbitrave (të tilla si shpenzimet e udhëtimit dhe dietat e arbitrave ose sekretarit të gjykatës së arbitrazhit, shpenzimet për dërgesat e njoftimeve, qiranë, tarifat e sekretarit gjyqësor), duke përfshirë tatimin mbi vlerën e shtuar të zbatueshëm; si dhe

1.2 shpenzimet e palëve, siç janë shpenzimet e arsyeshme të palëve për përfaqësimin e tyre ligjor; dhe

1.3 shpenzime të tjera në lidhje me arbitrazhin, në veçanti ato të renditura në Nenin 43 paragrafi 1.

(2) Sekretari i Përgjithshëm do të llogarisë tarifat administrative dhe tarifat e arbitrave në bazë të listës së tarifave (Shtojca 3) sipas shumës së kërkuar në mosmarrëveshjen ndërmjet palëve dhe do të përcaktojë këto tarifa së bashku me shpenzimet në fund të procedurës së arbitrazhit (paragrafi 1.1 i këtij Neni). Përpara përfundimit të procedurës së arbitrazhit, Sekretari i Përgjithshëm mund të transferojë pagesat në llogaritë e arbitrave në varësi të fazës ku ndodhet procedura. Gjykata e arbitrazhit do të përcaktojë dhe rregullojë në vendimin përfundimtar shpenzimet e arbitrazhit dhe shpenzime të tjera sipas paragrafit 1.2 dhe 1.3 të këtij Neni (Neni 38).

(3) Në përcaktimin e shumës në mosmarrëveshje, Sekretari i Përgjithshëm mund të devijojë nga shuma e pretenduar nga palët nëse palët kanë paraqitur një pretendim të pjesshëm ose nëse një palë e ka nënvlerësuar pretendimin e saj ose nuk i ka atribuar asnjë vlerë.

(4) Nëse më shumë se dy palë janë të përfshira në një procedurë arbitrazhi, vlera e tarifave administrative dhe tarifave të arbitrave të renditura në Shtojcën 3 do të rritet me 10 për qind për secilën palë shtesë, deri në një rritje maksimale prej 50 për qind. Kjo shumë e rritur më pas do të jetë bazë për një rritje apo ulje të mëtejshme sipas paragrafit 8 të këtij Neni.

(5) Për kundërpaditë (Neni 9), Sekretari i Përgjithshëm llogarit dhe përcakton veçmas tarifat administrative dhe tarifat e arbitrave.

(6) Për kërkimet e ngritura si kompensim ndaj pretendimeve të padisë fillestare, Sekretari i Përgjithshëm mund të llogarisë dhe të përcaktojë veçmas tarifën administrative dhe të arbitrave për atë sa këto pretendime janë kërkuar për t'u shqyrtuar si çështje shtesë nga gjykata e arbitrazhit.

(7) Për kërkesat për thirrje të personave të tretë (Neni 14), Sekretari i Përgjithshëm mund të llogarisë dhe të përcaktojë veçmas tarifën administrative dhe tarifën e arbitrave, në varësi të rrethanave të çështjes.

(8) Tarifën e arbitrave të renditura në Shtojcën 3 zbatohen për arbitrat e vetëm. Tarifa totale për një trup gjykues arbitrash është dy herë e gjysmë më e lartë se tarifa e një arbitri të vetëm. Sekretari i Përgjithshëm mund të rrisë tarifën e arbitrave sipas diskrecionit të tij me një maksimum prej 40 për qind të listës së tarifave (Shtojca 3), veçanërisht për çështje komplekse ose për zhvillimin efikas të procedurave; anasjelltas, Sekretari i Përgjithshëm mund të aplikojë një ulje deri në 40 për qind mbi tarifën e arbitrave, veçanërisht për zhvillimin joefikas të procedurave.

(9) Tarifën e renditura në Shtojcën 3 përfshijnë të gjitha vendimet e pjesshme dhe të ndërmjetme, të tilla si vendimet për juridiksionin, vendimet e pjesshme, vendimet për kundërshtimin e ekspertëve, urdhrat për marrjen e masave konservative ose të ndërmjetme të sigurimit, vendimet e tjera duke përfshirë hapat proceduralë shtesë në pushimin e procedurës dhe urdhrat proceduralë.

(10) Reduktimi i shumës objekt mosmarrëveshjeje do të merret në konsideratë në llogaritjen e tarifave administrative dhe të arbitrave vetëm nëse është bërë përpara dërgimit të dosjes në gjykatën e arbitrazhit.

(11) Nëse procedura ose mandati i arbitrit ndërpritet para kohe, Sekretari i Përgjithshëm mund të reduktojë tarifën administrative dhe të arbitrave sipas diskrecionit të tij, duke marrë parasysh fazën në të cilën ndodhet procedura në momentin e përfundimit. Nëse procedura e arbitrazhit sipas Rregullave të Vjenës fillon përpara, gjatë ose pas procedurës sipas Rregullave të Ndërmjetësimit të Vjenës ndërmjet të njëjtave palë dhe në lidhje me të njëjtën çështje, Sekretari i Përgjithshëm mund të zbatojë me analogji këtë paragraf për llogaritjen e tarifave të arbitrave.

(12) Nëse procedura sipas Rregullave të Ndërmjetësimit të Vjenës fillon përpara, gjatë ose pas procedurës së arbitrazhit sipas Rregullave të Vjenës ndërmjet të njëjtave palë dhe në lidhje me të njëjtën çështje, tarifat administrative të procedurës së mëparshme do të zbriten nga tarifat administrative në procedurën e filluar më pas.

(13) Tarifat e renditura në Shtojcën 3 nuk përfshijnë tatimin mbi vlerën e shtuar, i cili mund të zbatohet për tarifat e arbitrit. Pas pranimit të mandatit të tyre, arbitrat tarifat e të cilëve janë subjekt i tatimit mbi vlerën e shtuar duhet të informojnë Sekretarin e Përgjithshëm për shumën e mundshme të tatimit mbi vlerën e shtuar.

DISPOZITA TË NDRYSHME

PROCEDURAT E PËRSHPEJTUARA

Neni 45

(1) Rregullat plotësuese për procedurën e përshpejtuar zbatohen nëse palët shprehimisht i kanë përfshirë në marrëveshjen e tyre të arbitrazhit ose nëse palët bien më pas dakord për zbatimin e tyre. Palët do të bien dakort për zhvillimin e procedurës së përshpejtuar jo më vonë se dorëzimi i deklaratës së mbrojtjes.

(2) Nëse rregullat për procedurën e përshpejtuar nuk parashikojnë ndryshe, dispozitat e përgjithshme të Rregullave të Vjenës do të zbatohen me ndryshimet e mëposhtme:

(3) Afati për pagesën e paradhënies për shpenzimet sipas Nenit 42 reduktohet në 15 ditë.

(4) Kundërpaditë ose paditë për kompensim janë të pranueshme vetëm deri në përfundimin e afatit për paraqitjen e deklaratës së mbrojtjes.

(5) Procedura e përshpejtuar do të gjykohet nga një arbitër i vetëm, përveç nëse palët kanë rënë dakord për një trup gjykues arbitrash.

(6) Nëse mosmarrëveshja do të shqyrtohet nga një arbitër i vetëm, palët do të emërojnë së bashku një arbitër të vetëm brenda 15 ditëve nga marrja e një kërkesë për emërim nga Sekretari i Përgjithshëm. Nëse palët nuk arrijnë të emërojnë arbitrin e vetëm brenda këtij afati kohor, caktimi i tij do të bëhet nga Bordi.

(7) Kur çështja shqyrtohet nga trupi gjykues i arbitrave, paditësi do të emërojë një arbitër në kërkesëpadi. I padituri do të emërojë një arbitër brenda 15 ditëve nga marrja e një kërkesë nga Sekretari i Përgjithshëm. Arbitrat e emëruar nga palët do të emërojnë një kryetar brenda 15 ditëve nga marrja e kërkesës nga Sekretari i Përgjithshëm. Nëse një arbitër nuk emërohet brenda këtij afati kohor, caktimi i tij do të bëhet nga Bordi.

(8) Gjykata e arbitrazhit do të marrë një vendim përfundimtar brenda gjashtë muajve nga dërgimi i dosjes, përveç nëse procedura është mbyllur para kohe. Sekretari i Përgjithshëm mund të zgjasë afatin në bazë të një kërkesë të arsyetuar nga gjykata e arbitrazhit ose me nismën e tij. Tejkalimi i afatit kohor për vendimin nuk do ta bëjë marrëveshjen e arbitrazhit të pavlefshme ose privojë gjykatën e arbitrazhit nga juridiksioni i saj.

(9) Arbitrazhi do të administrohet në atë mënyrë që gjykata e arbitrazhit të mund të marrë një vendim përfundimtar brenda gjashtë muajve pas dërgimit të dosjes. Nëse gjykata e arbitrazhit nuk vendos ndryshe, do të zbatohen dispozitat e mëposhtme:

9.1 Pas paraqitjes së kërkesëpadisë dhe deklaratës së mbrojtjes, palët do të shkëmbejnë vetëm një parashtrim tjetër me shkrim.

9.2 Palët do të paraqesin të gjithë argumentet faktike në parashtrimet e tyre me shkrim dhe të gjitha provat me shkrim do t'i bashkëlidhen parashtrimeve me shkrim.

9.3 Për aq sa kërkohet nga një palë ose konsiderohet e nevojshme nga gjykata e arbitrazhit, kjo e fundit do të mbajë një seancë të vetme verbale, në të cilën do të merren të gjitha provat dhe do të trajtohen të gjitha çështjet ligjore.

9.4 Asnjë parashtrim me shkrim nuk do të depozitohet pas seancës dëgjimore.

MOSMBAJTJA E PËRGJEGJËSISË DHE HEQJA DORË NGA IMUNITETI

Neni 46

(1) Arbitri, sekretari i gjykatës, Sekretari i Përgjithshëm, Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm, Bordi dhe anëtarët e tij, si dhe Dhoma Ekonomike Federale Austriake dhe punonjësit e saj përjashtohen nga përgjegjësia për çdo veprim ose mosveprim në lidhje me arbitrazhin, përveç rastit kur një veprim ose mosveprim i tillë përbën shkelje me dashje ose nga pakujdesia e rëndë.

(2) Duke rënë dakord për të paraqitur një mosmarrëveshje në arbitrazh në përputhje me Rregullat e Vjenës, një palë do të konsiderohet se ka hequr dorë nga çdo e drejtë e imunitetit nga juridiksioni lidhur me procedurën e arbitrazhit për të cilin ajo palë përndryshe mund të ketë të drejtë. Heqja dorë nga imuniteti në lidhje me ekzekutimin e një vendimi arbitrazhi duhet të shprehet veçmas.

DISPOZITA KALIMTARE

Neni 47

Ky version i Rregullave të Vjenës, i cili hyn në fuqi më 1 korrik 2021, do të zbatohet për të gjitha procedurat që fillojnë pas datës 30 qershor 2021.

PJESA II

RREGULLAT E NDËRMJETËSIMIT TË VIAC RREGULLAT E NDËRMJETËSIMIT TË VJENËS 2021

VIAC DHE VERSIONI I ZBATUESHËM I RREGULLAVE TË NDËRMJETËSIMIT TË VJENËS

Neni 1

(1) Qendra Ndërkombëtare e Arbitrazhit të Vjenës (“VIAC”) është Institucioni i Përhershëm Ndërkombëtar i Arbitrazhit i Dhomës Ekonomike Federale Austriake¹. VIAC administron arbitrazhet vendase dhe ndërkombëtare, si dhe procedurat në përputhje me metodat e tjera alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, nëse palët kanë rënë dakord për Rregullat e Arbitrazhit të VIAC (“Rregullat e Vjenës”), Rregullat e Ndërmjetësit të VIAC (“Rregullat e Ndërmjetësit të Vjenës”), Rregullat e Arbitrazhit të Investimeve të VIAC (“Rregullat e Arbitrazhit të Investimeve të Vjenës”), Rregullat e Ndërmjetësit të Investimeve të VIAC (“Rregullat e Ndërmjetësit të Investimeve të Vjenës”); ose nëse është rënë dakord ose parashikuar ndryshe që VIAC duhet të shërbejë si institucion administrues.

(2) Nëse palët nuk kanë rënë dakord ndryshe, Rregullat e Ndërmjetësit të Vjenës do të zbatohen sipas versionit në fuqi në kohën e fillimit të procedurës nëse palët, para ose pasi të ketë lindur mosmarrëveshja, kanë rënë dakord të paraqesin mosmarrëveshjen e tyre sipas Rregullave të Ndërmjetësit të Vjenës.

(3) Rregullat e Ndërmjetësit të Vjenës mund të ndryshohen me marrëveshje me shkrim të të gjitha palëve. Pas caktimit të ndërmjetësit, çdo ndryshim i nënshtrohet edhe miratimit të ndërmjetësit.

(4) Bordi mund të refuzojë të administrojë procedurën sipas Rregullave të Ndërmjetësit të Vjenës nëse ndonjë ndryshim i rënë dakord është i papajtueshëm me Rregullat e Ndërmjetësit të Vjenës.

(5) Në masën që Rregullat e Ndërmjetësit të Vjenës nuk përmbajnë ndonjë rregull për një çështje specifike dhe në masën që përputhet me Rregullat e Ndërmjetësit të Vjenës, Rregullat e Vjenës do të zbatohen sipas analogjisë.

¹ Sipas seksionit 139, paragrafi 2 i Statutit Federal për Dhomat Ekonomike 1998 (“Wirtschaftskammergesetz 1998”), Fletorja Zyrtare Federale I Nr. 103/1998 i ndryshuar nga Fletorja Zyrtare Federale I Nr. 27/2021.

(1) Në Rregullat e Ndërmjetësimit të Vjenës

1.1 procedurë i referohet një ndërmjetësimi, çdo metode tjetër alternative për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të zgjedhur nga palët, ose një kombinimi të metodave të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve që mbështetet nga një person i tretë asnjëanës dhe që zhvillohet sipas Rregullave të Ndërmjetësimit të Vjenës;

1.2 person i tretë asnjëanës i referohet një ndërmjetësi, një pajtuesi, një ose disa personave të tjerë asnjëanës që mbështetin palët në zgjidhjen e mosmarrëveshjes së tyre, por nuk kanë autoritet për të marrë një vendim të formës së prerë për mosmarrëveshjen e palëve; në vijim, termi “ndërmjetës” përdoret si zëvendësim për të gjithë personat e tretë asnjëanës;

1.3 pala i referohet një ose më shumë palëve që bien dakord ose kanë rënë dakord të paraqesin mosmarrëveshjen e tyre sipas Rregullave e Ndërmjetësimit të Vjenës;

1.4 Bordi, Sekretari i Përgjithshëm dhe Sekretariati do të kenë kuptimin dhe funksionet e përcaktuara në Nenet 2 dhe 4 të Rregullave të Arbitrazhit të VIAC (“Rregullat e Vjenës”).

(2) Në masën që termat e përdorur në Rregullat e Ndërmjetësimit të Vjenës i referohen individëve, forma e zgjedhur do të zbatohet për të gjitha gjinitë. Në praktikë, termat në këto rregulla do të përdoren në mënyrë specifike për gjininë.

(3) Referencat për “Nenet” pa specifikime të mëtejshme kanë të bëjnë me Nenet përkatëse të Rregullave të Ndërmjetësimit të Vjenës.

FILLIMI I PROCEDURËS

Neni 3

(1) Procedura fillon me paraqitjen e kërkesës. Procedura do të fillojë në datën e marrjes së kërkesës nga Sekretariati i VIAC ose nga një Dhomë Ekonomike Rajonale Austriake në formë fizike ose në formë elektronike (Neni 12 paragrafi 1 i Rregullave të Vjenës), në rastin e një marrëveshjeje midis palëve për të paraqitur mosmarrëveshjen e tyre sipas Rregullave të Ndërmjetësimit të Vjenës. Në mungesë të një marrëveshjeje të tillë, procedura do të fillojë në datën në të cilën një marrëveshje e tillë është lidhur më pas nga palët.

(2) Kërkesa duhet të përfshijë sa më poshtë:

2.1 emrat e plotë, adresat, duke përfshirë adresat e postës elektronike dhe të dhënat e tjera të kontaktit të palëve dhe çdo koment për shtetësitë e palëve;

2.2 një përshkrim të shkurtër të fakteve dhe mosmarrëveshjes;

2.3 shumën e mosmarrëveshjes;

2.4 emrin e plotë, adresën dhe të dhënat e tjera të kontaktit të ndërmjetësit të emëruar, ose cilësitë që duhet të ketë ndërmjetësi që do të caktohet;

2.5 të dhënat ose propozimet në lidhje me një marrëveshje të palëve për të paraqitur mosmarrëveshjen e tyre për zgjidhje sipas Rregullave të Ndërmjetësimit të Vjenës, veçanërisht në lidhje me

- i. numrin e ndërmjetësve;
- ii. gjuhën/gjuhët që do të përdoret gjatë procedurës.

(3) Nëse kërkesa nuk është paraqitur bashkërisht nga të gjitha palët, Sekretari i Përgjithshëm i informon palët e tjera për marrjen e kërkesës dhe e dërgon atë për komente brenda një afati të caktuar.

TARIFA E REGJISTRIMIT

Neni 4

(1) Nëse ekziston një marrëveshje ndërmjet palëve për të paraqitur mosmarrëveshjen e tyre në Rregullat e Ndërmjetësimit të Vjenës, tarifa e regjistrimit do të paguhet neto në shumën e përcaktuar në Shtojcën 3 brenda afatit kohor të caktuar nga Sekretari i Përgjithshëm. Në mungesë të një marrëveshjeje të tillë, tarifa e regjistrimit do të paguhet vetëm pas lidhjes së mëvonshme të kësaj marrëveshjeje.

(2) Nëse në procedurën e arbitrazhit janë më shumë se dy palë, tarifa e regjistrimit do të rritet me 10 për qind për secilën palë shtesë, deri në një rritje maksimale prej 50 për qind.

(3) Tarifa e regjistrimit është e pakthyeshme. Tarifa e regjistrimit nuk do të zbritet nga pagesa paraprake për shpenzimet e palës paguese.

(4) Nëse procedura e arbitrazhit sipas Rregullave të Vjenës fillon përpara, gjatë ose pas procedurës së arbitrazhit sipas Rregullave të Ndërmjetësimit të Vjenës midis palëve të njëjta dhe në lidhje me të njëjtën çështje, nuk do të paguhet asnjë tarifë regjistrimi në procedurat e filluara më pas.

(5) Sekretari i Përgjithshëm mund të zgjasë afatin kohor për pagesën e tarifës së regjistrimit sipas rastit. Nëse pagesa nuk kryhet brenda afatit të caktuar, Sekretari i Përgjithshëm mund të deklarojë përfundimin e procedurës.

VENDI I SEANCEVE

Neni 5

Pavarësisht ndonjë procedure të mëparshme ose të njëkohshme arbitrazhi, ndërmjetësi, duke u konsultuar me palët dhe pasi të ketë marrë parasysh të gjitha rrethanat, do të përcaktojë vendin e seancës së ndërmjetësimit. Nëse ndërmjetësi e konsideron të përshtatshme, ai mund të përcaktojë një vend të ndryshëm për çdo seancë.

GJUHA E PROCEDURËS

Neni 6

Menjëherë pas dërgimit të dosjes (Neni 9 paragrafi 1), ndërmjetësi, pasi të jetë konsultuar me palët dhe duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat, do të përcaktojë gjuhën(t) e procedurës.

CAKTIMI I NDËRMJETËSIT

Neni 7

(1) Në mungesë të marrëveshjes së palëve për identitetin e ndërmjetësit ose mënyrën e caktimit, Sekretari i Përgjithshëm do të caktojë një afat kohor dhe do t'i ftojë palët që bashkërisht të emërojnë ndërmjetësin dhe të tregojnë emrin, adresën e tij, duke përfshirë adresën e postës elektronike dhe të dhënat e kontaktit.

(2) Sekretariati mund t'i ndihmojë palët në emërimin e përbashkët të ndërmjetësit, veçanërisht duke propozuar një ose më shumë persona nga të cilët palët mund të emërojnë bashkërisht një ose më shumë ndërmjetës. Nëse palët nuk arrijnë të emërojnë bashkërisht një ndërmjetës, Bordi do të caktojë ndërmjetësin. Duke vepruar kështu, Bordi do t'i kushtojë vëmendjen e duhur preferencave të palëve në lidhje me cilësitë e ndërmjetësit.

(3) Përpara caktimit të ndërmjetësit nga Bordi ose konfirmimit të ndërmjetësit të emëruar, ndërmjetësi duhet të nënshkruajë dhe t'i dorëzojë Sekretarit të Përgjithshëm një deklaratë që konfirmon (i) paanshmërinë dhe pavarësinë e tij, (ii) disponueshmërinë, (iii) kualifikimin, (iv) pranimin e detyrës dhe (v) respektimin ndaj Rregullave të Ndërmjetësit të Vjenës. Ndërmjetësi duhet të informojë me shkrim për të gjitha rrethanat që mund të shkaktojnë dyshime për paanshmërinë ose pavarësinë e tij ose që janë në kundërshtim me marrëveshjen e palëve. Kjo detyrë e ndërmjetësit vazhdon të zbatohet gjatë të gjithë procedurës. Sekretari i Përgjithshëm do t'ua dërgojë një kopje të këtyre deklaratave palëve për koment.

(4) Nëse nuk ka dyshime për paanshmërinë dhe pavarësinë e ndërmjetësit dhe aftësinë e tij për të përmbushur rregullisht mandatin e tij, Bordi do të caktojë ndërmjetësin ose Sekretari i Përgjithshëm do të konfirmojë ndërmjetësin e emëruar. Nëse gjykohet e nevojshme nga Sekretari i Përgjithshëm, Bordi do të vendosë nëse do të konfirmojë një ndërmjetës të emëruar. Përpara vendimit të

Bordit, Sekretari i Përgjithshëm mund të kërkojë që të konfirmohen komentet nga ndërmjetësi dhe nga palët. Të gjithë komentet do t'u komunikohen palëve dhe ndërmjetësit. Pas konfirmimit, ndërmjetësi i emëruar do të konsiderohet i caktuar.

(5) Nëse konfirmimi i ndërmjetësit refuzohet ose nëse zëvendësimi i ndërmjetësit bëhet i nevojshëm, paragrafët 1 deri 4 do të zbatohen *mutatis mutandis*.

PARADHËNIA PËR SHPENZIMET DHE SHPENZIMET

Neni 8

(1) Sekretari i Përgjithshëm do të përcaktojë një paradhënie paraprake për shpenzimet lidhur me tarifat e mundshme administrative të VIAC, parapagesën për tarifat e ndërmjetësit dhe shpenzimet e parashikuara (të tilla si shpenzimet e udhëtimit dhe të jetesës së ndërmjetësit, tarifat e dorëzimit, qiraja, etj.), duke përfshirë ndonjë tatim mbi vlerën e shtuar. Paradhënia paraprake për shpenzimet do të kryhet nga palët përpara dërgimit të dosjes tek ndërmjetësi dhe brenda një afati kohor të caktuar nga Sekretari i Përgjithshëm.

(2) Përveçse kur palët kanë rënë dakord ndryshe me shkrim, paradhënia për shpenzimet do të mbulohet nga palët në pjesë të barabarta, ndërsa në rastin e ndërmjetësit shumëpalësh ato ndahen proporcionalisht. Nëse paradhënia për shpenzimet e caktuara për njërën palë nuk merret ose nuk merret plotësisht brenda afatit kohor të specifikuar, Sekretari i Përgjithshëm do të informojë palën/palët tjetër. Pala/palët tjetër/e tjera ka/kanë lirinë të paguajnë pjesën e mbetur të paradhënies për shpenzimet. Nëse kjo pjesë nuk paguhet brenda afatit kohor të caktuar, ndërmjetësi mund të pezullojë procedurën tërësisht ose pjesërisht, ose Sekretari i Përgjithshëm mund të deklarojë përfundimin e procedurës (Neni 11 paragrafi 1.5).

(3) Nëse një paradhënie shtesë për shpenzimet është e nevojshme dhe e përcaktuar nga Sekretari i Përgjithshëm, veçanërisht për të mbuluar tarifat e ndërmjetësit dhe shpenzimet e parashikuara, do të zbatohet paragrafi 2 i këtij Neni.

(4) Pas përfundimit të procedurës, Sekretari i Përgjithshëm do të llogarisë tarifat administrative dhe tarifat e ndërmjetësit dhe do t'i caktojë këto tarifa së bashku me shpenzimet.

(5) Tarifat administrative do të llogariten në bazë të listës së tarifave (Shtojca 3) sipas shumës objekt mosmarrëveshjeje. Në përcaktimin e kësaj të fundit, Sekretari i Përgjithshëm mund të devijojë nga llogaritja e palëve nëse palët e kanë nënvlerësuar qartë ose nuk i kanë caktuar asnjë vlerë. Nëse në procedurë janë përfshirë më shumë se dy palë, shuma e tarifave administrative të renditura në Shtojcën 3 do të rritet me 10 për qind për çdo palë shtesë, deri në një rritje maksimale prej 50 për qind.

(6) Shuma e tarifave të ndërmjetësit llogaritet sipas kohës reale të shpenzuar në bazë të tarifave orare ose ditore. Tarifat do të caktohen nga Sekretari i Përgjithshëm në momentin e caktimit ose konfirmimit të ndërmjetësit pas konsultimit me ndërmjetësin dhe palët. Sekretari i Përgjithshëm do të marrë në konsideratë proporcionalitetin e tarifave si dhe do të marrë parasysh kompleksitetin e mosmarrëveshjes. Nuk do të ketë marrëveshje të veçanta tarifash ndërmjet palëve dhe ndërmjetësit.

(7) Përveç nëse është rënë dakord ndryshe me shkrim, palët do të marrin përsipër shpenzimet e tyre, duke përfshirë edhe shpenzimet e përfaqësimit ligjor.

(8) Nëse procedura e arbitrazhit sipas Rregullave të Vjenës ka filluar përpara, gjatë ose pas procedurës sipas Rregullave të Ndërmjetësimit të Vjenës ndërmjet palëve të njëjta dhe në lidhje me të njëjtën çështje, tarifat administrative të procedurës së mëparshme do të zbriten nga tarifat administrative në procedurën e nisur më pas.

ZHVILLIMI I PROCEDURËS

Neni 9

(1) Sekretari i Përgjithshëm ia dërgon dosjen ndërmjetësit nëse:

- është paraqitur një kërkesë në përputhje me Nenin 3;
- është caktuar ndërmjetësi; dhe
- është paguar plotësisht paradhënia për shpenzimet në përputhje me Nenin 8 paragrafi 1.

(2) Ndërmjetësi do të diskutojë menjëherë me palët për mënyrën e zhvillimit të procedurës. Ndërmjetësi do të ndihmojë palët në gjetjen e një zgjidhjeje të pranueshme dhe të kënaqshme për mosmarrëveshjen e tyre. Gjatë zhvillimit të

procedurës, ndërmjetësi do të jetë në kontroll të procedurës, duke e lënë veten të udhëhiqet nga dëshirat e palëve për sa kohë ato janë në pajtim dhe në përputhje me qëllimin e procedurës.

(3) Procedura mund të zhvillohet personalisht ose me mjete të tjera. Duke pasur parasysh rrethanat e çështjes dhe pas konsultimit me palët, ndërmjetësi mund të vendosë të përdorë çdo mjet teknologjik që e shih të përshtatshëm për të zhvilluar procedurën nga distanca. Në çdo rast, ndërmjetësi do të përpiqet t'i trajtojë në mënyrë të drejtë palët.

(4) Palët janë të lira të zgjedhin ekipin e tyre të ndërmjetësve. Ndërmjetësi mund të ofrojë udhëzime në lidhje me këtë. Secila palë do të marrë pjesë personalisht në një seancë me ndërmjetësin, ose do të përfaqësohet nga një person i caktuar dhe i autorizuar rregullisht që ka autoritetin për të zgjidhur mosmarrëveshjen. Emri, adresa dhe funksioni i këtyre personave do t'u njoftohet të gjitha palëve dhe ndërmjetësit përpara ndërmjetësimit ose pa vonesë. Ky njoftim do të tregojë gjithashtu rolin e synuar të këtij personi në ndërmjetësim.

(5) Gjatë të gjithë procedurës, palët do të veprojnë në mirëbesim, në mënyrë të drejtë dhe me respekt.

(6) Seancat me ndërmjetësin nuk janë publike. Vetëm individët e mëposhtëm do të lejohen të marrin pjesë:

- ndërmjetësi;
- palët; dhe
- personat, prania e të cilëve i është njoftuar ndërmjetësit dhe palës tjetër në kohën e duhur përpara seancës përkatëse (paragrafi 4 i këtij Neni) dhe të cilët kanë nënshkruar një marrëveshje konfidencialiteti me shkrim në përputhje me Nenin 12.

(7) Nëse ndërmjetësi e konsideron të përshtatshme, ai mund të takohet me njërin palë në mungesë të palës tjetër (*caucus*). Ndërmjetësi do të ruajë konfidencial informacionin e dhënë nga njëra palë në mungesë të palës tjetër, përveç nëse pala që e jep informacionin heq dorë shprehimisht nga konfidencialiteti kundrejt palës tjetër dhe ndërmjetësi pranon t'ia kalojë një informacion të tillë.

PROCEDURAT E NJËKOHSHME

Neni 10

Një palë mund të fillojë ose të vazhdojë çdo procedurë ligjore, arbitrazhi ose procedurë tjetër në lidhje me të njëjtën mosmarrëveshje, pavarësisht nëse procedura po zhvillohet sipas Rregullave të Ndërmjetësimit të Vjenës.

PËRFUNDIMI I PROCEDURËS

Neni 11

(1) Procedura do të përfundojë me anë të një njoftimi me shkrim nga Sekretari i Përgjithshëm për palët dhe pasi cilado prej rrethanave më poshtë të ketë ndodhur e para:

1.1 një marrëveshje e palëve për të zgjidhur të gjithë mosmarrëveshjen;

1.2 njoftimi me shkrim i secilës palë drejtuar ndërmjetësit ose Sekretarit të Përgjithshëm se nuk dëshiron të vazhdojë procedurën;

1.3 njoftimi me shkrim i ndërmjetësit drejtuar palëve se procedura, sipas mendimit të tij, nuk do ta zgjidhë mosmarrëveshjen ndërmjet tyre;

1.4 njoftimi me shkrim i ndërmjetësit drejtuar palëve se procedura ka përfunduar;

1.5 njoftimi me shkrim i Sekretarit të Përgjithshëm se

i. nuk është caktuar një ndërmjetës në përputhje me Nenin 7 paragrafët 1 deri 4;

ii. nuk është kryer pagesa në përputhje me urdhërpagesën (Nenet 4 dhe 8) në kohën e duhur.

(2) Procedura mund të përfundojë pjesërisht edhe nëse një nga shkaqet e përfundimit të përmendura në paragrafin 1 zbatohet vetëm për një pjesë të mosmarrëveshjes.

(3) Në rastet e renditura në paragrafët 1.1 deri 1.4 dhe paragrafin 2, ndërmjetësi do ta informojë Sekretarin e Përgjithshëm menjëherë për rrethanat e përfundimit.

KONFIDENCIALITETI, PRANIMI I PROVAVE DHE PËRFAQËSIMI NË VIJIM

Neni 12

(1) Personat e renditur në Nenin 9, paragrafi 6 do të trajtojnë si konfidencial çdo informacion për të cilin janë vënë në dijeni lidhur me procedurën dhe që nuk do të ishin vënë në dijeni po të mos ishte zhvilluar procedura.

(2) Dokumentet me shkrim që janë marrë gjatë procedurës dhe që përndryshe nuk do të ishin marrë, nuk do të përdoren në procedurat e mëvonshme ligjore, të arbitrazhit ose në procedura të tjera. Çdo deklaratë, opinion, propozim dhe pranim i bërë gjatë procedurës, si dhe vullneti i çdo pale për të zgjidhur miqësisht mosmarrëveshjen do të mbeten gjithashtu konfidenciale. Në lidhje me ndonjë ose të gjitha sa më sipër, ndërmjetësi nuk thirret si dëshmitar.

(3) Detyrimet sipas paragrafëve 1 dhe 2 nuk zbatohen nëse ligji që rregullon këtë procedurë ka dispozita të detyrueshme në kundërshtim me këto nene ose nëse dhënia e informacionit kërkohet për ekzekutimin ose zbatimin e marrëveshjes për ndërprerjen e kësaj procedure.

(4) Fakti që procedura është duke u zhvilluar, është zhvilluar ose do të zhvillohet nuk do të jetë konfidencial.

(5) Ndërmjetësi nuk mund të veprojë si avokat ose t'i përfaqësojë palët në çfarëdo cilësie ose ndryshe t'i këshillojë palët në procedura ligjore, arbitrazhi ose të tjera në lidhje me mosmarrëveshjen që përbën ose përbënte objektin e procedurës sipas Rregullave të Vjenës.

MOSMBAJTJA E PËRGJEGJËSISË

Neni 13

Ndërmjetësi, Sekretari i Përgjithshëm, Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm, Bordi dhe anëtarët e tij, si dhe Dhoma Ekonomike Federale Austriake dhe punonjësit e saj përjashtohen nga përgjegjësia për çdo veprim ose mosveprim në lidhje me procedurat sipas Rregullave të Ndërmjetësimit të Vjenës, përveç rastit kur një veprim ose mosveprim i tillë përbën shkelje me dashje ose nga pakujdesia e

rëndë.

DISPOZITA KALIMTARE

Neni 14

Ky version i Rregullave të Ndërmjetësimit të Vjenës, i cili hyn në fuqi më 1 korrik 2021, do të zbatohet për të gjitha procedurat që fillojnë pas datës 30 qershor 2021.

PJESA III



SHTOJCAT

**E RREGULLAVE TË ARBITRAZHIT DHE NDËRMJETËSIMIT TË
VIAC**

SHTOJCA 1

DISPOZITA MODEL

DISPOZITA E ARBITRAZHIT

Kur palët dëshirojnë të paraqesin një kërkesë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në arbitrazh në përputhje me Rregullat e Vjenës, ato mund të bien dakord për një dispozitë arbitrazhi në formën e mëposhtme:

Të gjitha mosmarrëveshjet ose pretendimet që lindin nga ose në lidhje me këtë kontratë, duke përfshirë mosmarrëveshjet në lidhje me vlefshmërinë, shkeljen, zgjidhjen ose pavlefshmërinë e saj, do të zgjidhen përfundimisht sipas Rregullave të Arbitrazhit (Rregullat e Vjenës) të Qendrës Ndërkombëtare të Arbitrazhit në Vjenë (VIAC) të Dhomës Ekonomike Federale të Austrisë nga një ose tre arbitra të caktuar në përputhje me këto Rregulla.

Palët mund të parashikojnë në dispozitën e arbitrazhit sa më poshtë:

- (1)** numrin e arbitrave (një ose tre) (Neni 17 i Rregullave të Vjenës);
- (2)** gjuhën(ët) që do të përdoret në procedurën e arbitrazhit (Neni 26 i Rregullave të Vjenës);
- (3)** ligjin material të zbatueshëm për marrëdhënien kontraktuale, ligjin material të zbatueshëm për marrëveshjen e arbitrazhit (Neni 27 i Rregullave të Vjenës) dhe rregullat e zbatueshme për procedurën e arbitrazhit (Neni 28 i Rregullave të Vjenës);
- (4)** zbatueshmërinë e dispozitave për procedurën e përshpejtuar (Neni 45 i Rregullave të Vjenës);
- (5)** objektin e konfidencialitetit të arbitrave (Neni 16, paragrafi 2 i Rregullave të Vjenës) dhe shtrirjen e tij në lidhje me palët, përfaqësuesit dhe ekspertët.
- (6)** Nëse palët dëshirojnë të zhvillojnë procedurat e Arbitrazhit – Ndërmjetësimit – Arbitrazhit, në dispozitën model të arbitrazhit duhet të përfshihet edhe shtesa si më poshtë:

Gjithashtu, palët bien dakord që së bashku të marrin në konsideratë, pas fillimit të arbitrazhit, zhvillimin e procedurës në përputhje me Rregullat e Ndërmjetësimit të Qendrës Ndërkombëtare të Arbitrazhit në Vjenë (VIAC), të Dhomës Ekonomike Federale të Austrisë (Rregullat e Ndërmjetësimit të Vjenës). Marrëveshjet e arritura nga kjo procedurë do t'i referohen gjykatës së arbitrazhit të caktuar në arbitrazh. Gjykata e arbitrazhit mund të marrë një vendim sipas kushteve të rëna dakord që pasqyrojnë përmbajtjen e marrëveshjes (Neni 37, paragrafi 1 i Rregullave të Vjenës).

DISPOZITAT E NDËRMJETËSIMIT

Kur palët dëshirojnë të paraqesin një kërkesë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me ndërmjetësim ose metoda të tjera alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me Rregullat e Ndërmjetësimit të Vjenës, ato mund të bien dakord për një dispozitë ndërmjetësimi në një nga format e mëposhtme:

Modeli 1 i Dispozitës: Ndërmjetësimi Opcional

Në lidhje me të gjitha mosmarrëveshjet ose pretendimet që lindin nga ose në lidhje me këtë kontratë, duke përfshirë mosmarrëveshjet në lidhje me vlefshmërinë, shkellen, zgjidhjen ose pavlefshmërinë e saj, palët bien dakord të marrin në konsideratë së bashku procedurën në përputhje me Rregullat e Ndërmjetësimit (Rregullat e Ndërmjetësimit të Vjenës) të Qendrës Ndërkombëtare të Arbitrazhit në Vjenë (VIAC) të Dhomës Ekonomike Federale të Austrisë.

Modeli 2 i Dispozitës: Detyrimi për të Referuar Kërkesën për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve me Ndërmjetësim dhe më pas Arbitrazh

Të gjitha mosmarrëveshjet ose pretendimet që lindin nga ose në lidhje me këtë kontratë, duke përfshirë mosmarrëveshjet në lidhje me vlefshmërinë, shkellen, zgjidhjen ose pavlefshmërinë e saj, fillimisht do t'i nënshtrohen procedurës në përputhje me Rregullat e Ndërmjetësimit (Rregullat e Ndërmjetësimit të Vjenës) të Qendrës Ndërkombëtare të Arbitrazhit në Vjenë (VIAC) të Dhomës Ekonomike Federale të Austrisë.

Në rast se brenda [60]¹ ditëve nga fillimi i procedurës sipas Rregullave të

¹ ose një periudhë tjetër e pranuar me shkrim nga palët

Ndërmjetësimi të Vjenës, mosmarrëveshja ose pretendimet nuk janë zgjidhur, ato do të zgjidhen përfundimisht sipas Rregullave të Arbitrazhit (Rregullat e Vjenës) të VIAC nga një ose tre arbitra të caktuar në përputhje me këto Rregulla.²

Modeli 3 i Dispozitës: Detyrimi për të Referuar Kërkesën për Zgjidhje të një Mosmarrëveshje Ekzistuese me Ndërmjetësim

Palët bien dakord që mosmarrëveshja ekzistuese do t'i nënshtrohet procedurës në përputhje me Rregullat e Ndërmjetësimi (Rregullat e Ndërmjetësimi të Vjenës) të Qendrës Ndërkombëtare të Arbitrazhit në Vjenë (VIAC) të Dhomës Ekonomike Federale të Austrisë. Procedura do të fillojë me paraqitjen e një kërkesë të përbashkët. Tarifa e regjistrimit do të mbulohet nga palët në mënyrë të barabartë.

Palët mund të parashikojnë në dispozitën e ndërmjetësimi sa më poshtë:

- (1)** numrin e ndërmjetësuesve ose palëve neutrale të tjetra (p.sh një ose dy);
- (2)** gjuhën(ët) që do të përdoret në procedurë (Neni 6 i Rregullave të Ndërmjetësimi të Vjenës);
- (3)** ligjin material të zbatueshëm për marrëdhënien kontraktuale, ligjin material të zbatueshëm për marrëveshjen e ndërmjetësimi, dhe rregullat e zbatueshme për procedurën (Neni 1 paragrafi 3 i Rregullave të Ndërmjetësimi të Vjenës);
- (4)** pranueshmërinë e procedurave paralele (Neni 10 i Rregullave të Ndërmjetësimi të Vjenës);
- (5)** ndërprerjen e parashkrimit ose heqjen dorë nga kërkesa e parashkrimit për një periudhë kohore të caktuar.

MODELI I DISPOZITËS PËR V

² shikoni marrëveshjet shtesë opsionale për dispozitat e arbitrazhit

IAC SI AUTORITETI CAKTUES

Rekomandohet që palët që dëshirojnë të zgjedhin VIAC si autoritetin caktues në përputhje me Shtojcën 4, të përfshijnë formulimin e mëposhtëm në dispozitën e tyre të arbitrazhit/ndërmjetësimit:

Qendra Ndërkombëtare e Arbitrazhit në Vjenë (VIAC) e Dhomës Ekonomike Federale të Austrisë do të veprojë si autoriteti caktues në përputhje me Shtojcën 4 të Rregullave të Arbitrazhit dhe Ndërmjetësimit të VIAC.

MODELI I DISPOZITËS PËR VIAC SI AUTORITETI ADMINISTRUES

Rekomandohet që palët që dëshirojnë të zgjedhin VIAC si autoritetin administrues në përputhje me Shtojcën 5, të përfshijë formulimin e mëposhtëm në dispozitën e tyre të arbitrazhit/ndërmjetësimit:

Qendra Ndërkombëtare e Arbitrazhit në Vjenë (VIAC) e Dhomës Ekonomike Federale të Austrisë do të veprojë si autoriteti administrues në përputhje me Shtojcën 5 të Rregullave të Arbitrazhit dhe Ndërmjetësimit të VIAC.

MODELI I DISPOZITËS SË ARBITRAZHIT PËR MOSMARRËVESHJET NË LIDHJE ME TRASHËGIMINË

Kur trashëgimlënësi dëshiron të parashikojë qe zgjidhja e mosmarrëveshjes për trashëgiminë të bëhet në arbitrazh në përputhje me Shtojcën 6 të Rregullave të Vjenës, trashëgimlënësi mund të përfshijë në disponimin e pasurisë pas vdekjes / marrëveshjen për trashëgiminë / testament një dispozitë të arbitrazhit në formën e mëposhtme:

Të gjitha mosmarrëveshjet ose pretendimet që lindin nga ose në lidhje me këtë [trashëgimi / disponim të pasurisë pas vdekjes / marrëveshje për trashëgimi / testament] të [emër, mbiemër, datëlindja, shtetësia, adresa e trashëgimlënësit], duke përfshirë mosmarrëveshjet në lidhje me trashëgiminë, ekzistencën e trashëgimisë, përmbajtjen dhe vlefshmërinë e [disponimit të pasurisë pas vdekjes/marrëveshjes për trashëgimi / testamentit], do të zgjidhen përfundimisht sipas Shtojcës 6 të Rregullave të Arbitrazhit (Rregullat e

Vjenës) të Qendrës Ndërkombëtare të Arbitrazhit në Vjenë (VIAC) të Dhomës Ekonomike Federale të Austrisë, nga një ose tre arbitra të caktuar në përputhje me këto Rregulla.

Trashëgimlënësi mund të parashikojë në dispozitën e arbitrazhit sa më poshtë:

- (1)** numrin e arbitrave (një ose tre) (Neni 17 i ndryshuar me Shtojcën 6 të Rregullave të Vjenës)
- (2)** vendin e arbitrazhit (Neni 25 i ndryshuar me Shtojcën 6 të Rregullave të Vjenës)
- (3)** gjuhën(ët) që do të përdoret në procedurën e arbitrazhit (Neni 26 i ndryshuar me Shtojcën 6 të Rregullave të Vjenës);
- (4)** ligjin e zbatueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes trashëgimore dhe ligjin e zbatueshëm për marrëveshjen e arbitrazhit (sipas Nenit 27 paragrafi i parë i ndryshuar me Shtojcën 6 të Rregullave të Vjenës, ligji i zbatueshëm do të jetë ai ligj i zbatueshëm sipas rregullave të konfliktit të ligjeve të vendbanimit të personit në kohën e vdekjes, ose ligji që mund të zgjidhet sipas tij);
- (5)** objektin e konfidencialitetit të arbitrave (Neni 16 paragrafi 2 i Rregullave të Vjenës) dhe shtrirjen e tij në lidhje me palët, përfaqësuesit dhe ekspertët.

SHTOJCA 2

RREGULLAT E BRENDSHME TË BORDIT¹

- (1) Mbledhjet e Bordit thirren nga Kryetari dhe drejtohen nga ai ose nga Nënkryetari.
- (2) Bordi do të formojë një kuorum nëse më shumë se një e treta e anëtarëve të tij marrin pjesë. Pjesëmarrja mund të realizohet edhe me anë të lidhjes telefonike ose videokonferencës, si dhe nëpërmjet internetit.
- (3) Bordi do të marrë vendime me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të pranishëm që kanë të drejtën e votës. Në rast barazimi votash, vota e anëtarit kryesues do të prevalojë.
- (4) Nëse Nënkryetarët do të pengohen për të ushtruar detyrat e tyre, detyrat e Kryetarit do të kryhen nga anëtari më i vjetër në varësi të kohëzgjatjes së mandatit të tij si anëtar i Bordit. Në rast të kundërt, Zëvendëskryetari me kohëzgjatjen më të gjatë të mandatit si anëtar i Bordit do t'i kryejë këto detyra.
- (5) Anëtarët e Bordit të cilët janë ose kanë vepruar në çfarëdo cilësie në një arbitrazh të administruar nga Qendra Ndërkombëtare e Arbitrazhit në Vjenë nuk do të lejohen të jenë të pranishëm ose të marrin pjesë në asnjë mënyrë në diskutimet ose vendimet që kanë të bëjnë me të njëjtën procedurë. Kjo nuk do të dëmtojë ekzistencën e një kuorumi të Bordit.
- (6) Vendimet e marra me korrespondencë janë të pranueshme. Në rastin e fundit, Kryetari do t'i paraqesë anëtarëve një propozim me shkrim dhe do të caktojë një afat kohor për dhënien e votës me shkrim. Nenet 2 dhe 3 të kësaj Shtojce do të zbatohen në mënyrë analogjike. Çdo anëtar ka të drejtë të kërkojë një takim në lidhje me propozimin me shkrim.
- (7) Bordi nuk është i detyruar të deklarojë arsyet mbi të cilat bazohen vendimet e tij.

¹ Statuti i datës 1 korrik 2021

SHTOJCA 3

GRAFIKU I TARIFAVE¹

Tarifa e regjistrimit²

Shuma e mosmarrëveshjes ne Euro		Norma në Euro
nga	në	
	25,000	500
25,001	75,000	1,000
mbi 75,000		1,500

Tarifat administrative³

Shuma e mosmarrëveshjes ne Euro		Norma në Euro
nga	në	
	25,000	500
25,001	75,000	1,000
75,001	100,000	1,500
100,001	200,000	3,250 + 1.875 % të shumës mbi 100,000
200,001	500,000	5,125 + 1.250 % të shumës mbi 200,000
500,001	1,000,000	9,125 + 0.875 % të shumës mbi 500,000
1,000,001	2,000,000	13,500 + 0.500 % të shumës mbi 1,000,000

¹ Shih llogaritjen e shpenzimeve në faqen ueb të VIAC (<https://www.viac.eu/en/arbitration/cost-calculator>)

² Shih Nenin 10 të Rregullave të Vjenës; Nenin 4 të Rregullave të Ndërmjetësimit të Vjenës

³ Shih Nenin 44, paragrafët 2 dhe 4 të Rregullave të Vjenës; Nenin 8, paragrafi 5 të Rregullave të Ndërmjetësimit të Vjenës

2,000,001	15,000,000	18,500 + 2,000,000	0.150 % të shumës mbi
15,000,001	40,000,000	38,000 + 15,000,000	0.058 % të shumës mbi
mbi 40,000,000		52,500 + 40,000,000	0.045 % të shumës mbi
		në total prej 75,000 (52,500 + 22,500)	

Tarifat për Arbitrat e Vetëm⁴

Shuma e mosmarrëveshjes ne Euro		Norma në Euro	
nga	në		
	100,000	6 %, tarifa minimale 3,000	
100,001	200,000	6,000+	3.00 % të shumës mbi 100,000
200,001	500,000	9,000+	3.10 % të shumës mbi 200,000
500,001	1,000,000	18,300+	2.30 % të shumës mbi 500,000
1,000,001	2,000,000	29,800+	1.10 % të shumës mbi 1,000,000
2,000,001	5,000,000	40,800+	0.66 % të shumës mbi 2,000,000
5,000,001	10,000,000	60,600+	0.45 % të shumës mbi 5,000,000
10,000,001	20,000,000	83,100	+0.21 % të shumës mbi 10,000,000
20,000,001	100,000,000	104,100	+ 0.088 % të shumës mbi 20,000,000
100,000,001	500,000,000	174,500	+ 0.031 % të shumës mbi 100,000,000
mbi 500,000,000		298,500	+ 0.01% të shumës mbi 500,000,000

⁴ Shih Nenin 44, në veçanti paragrafët 2, 4, 8 dhe 11 të Rregullave të Vjenës

SHTOJCA 4

VIAC SI AUTORITETI CAKTUES

VIAC mund të caktohet për të vepruar si autoriteti caktues në procedurat ad hoc.

VIAC SI AUTORITETI CAKTUES

Neni 1

(1) VIAC mund të caktohet si autoriteti caktues në përputhje me Shtojcën 4 sipas kontratës, ligjit, traktatit, marrëveshjes së palëve në mosmarrëveshje ose nga Sekretari i Përgjithshëm i Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit në Hagë.

(2) VIAC mund të ofrojë shërbimet e mëposhtme si autoriteti caktues:

2.1 caktimin e arbitrave ose personave të tretë neutral;

2.2 caktimin e arbitrave zëvendësues dhe personave të tjerë neutralë;

2.3 caktimin e ekspertëve;

2.4 vendimin për kundërshtimet e arbitrave;

2.5 të asistojë në vendosjen e tarifave dhe shpenzimeve të arbitrave dhe palëve të tjera neutrale si dhe në rishikimin e këtyre tarifave dhe shpenzimeve;

2.6 komente këshilluese në lidhje me pagesën paraprake për shpenzimet.

(3) Përveç kur palët kanë rënë dakord ndryshe, kur i kërkohet caktimi i një arbitri, VIAC do të ndjekë procedurën e parashikuar në Nenet 16-18 të Rregullave të Vjenës dhe, kur i kërkohet caktimi i një pale tjetër neutrale, procedurën e parashikuar në Nenin 7 të Rregullave të Ndërmjetësisimit të Vjenës, përkatësisht.

(4) Kur i kërkohet kundërshtimi i një arbitri dhe përveç kur palët bien dakord ndryshe, VIAC do të ndjekë procedurën e kundërshtimit të parashikuar në Nenin 20 dhe në vijim të Rregullave të Vjenës.

KËRKESA

Neni 2

(1) Një kërkesë do t'i paraqitet VIAC në përputhje me Nenin 12 të Rregullave të Vjenës dhe duhet të jetë:

1.1 me shkrim në një nga gjuhët e korrespondencës së VIAC (anglisht ose gjermanisht);

1.2 me datë;

1.3 e nënshkruar nga pala/palët kërkuese ose përfaqësuesi(ët) e saj/tyre të autorizuar rregullisht. Nëse kërkesa është nënshkruar nga një përfaqësues, ajo duhet të ketë bashkëlidhur vërtetimin e autorizimit, p.sh një prokurë ose marrëveshje bashkëpunimi.

(2) Një kërkesë duhet të përfshijë informacionin e mëposhtëm:

2.1 një përshkrim të llojit të caktimit të kërkuar siç përshkruhet në Nenin 1, paragrafi 2;

2.2 një përshkrim të llojit të mosmarrëveshjes;

2.3 një kopje të kërkesëpadisë ose të ndonjë kërkesë tjetër fillestare me shkrim, deklaratën e mbrojtjes ose çdo përgjigje ndaj saj nga pala/ët e tjera, si dhe çdo kërkesë ose korrespondencë tjetër nga palët;

2.4 dispozitën për zgjidhjen e mosmarrëveshjes dhe dispozitën që emëron VIAC si autoritetin caktues;

2.5 emrat e plotë, adresat, duke përfshirë adresat e postës elektronike dhe detajet e tjera të kontaktit të palëve dhe përfaqësuesve të tyre, dhe çdo koment mbi shtetësinë e palëve;

2.6 emrin dhe shtetësinë e çdo arbitri/personi të tretë neutral/eksperti të caktuar, nëse ka informacion mbi mënyrën e caktimit dhe çdo deklaratë të bërë prej tyre;

2.7 gjuhën(ët) e procedurës.

SHPENZIMET

Neni 3

(1) Nëse VIAC kërkohet që të veprojë si autoriteti caktues sipas kësaj Shtojce, pala/palët kërkuese do të paguajë një tarifë të pakthyeshme në shumën prej 3,000 Euro për çdo shërbim të kërkuar. Kërkesa do të trajtohet vetëm pasi kjo tarifë të paguhet plotësisht.

(2) Në rrethana të veçanta, VIAC mund të shmangë shumat e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij Neni.

KUFIZIMI I PËRGJEGJËSISË

Neni 4

Arbitri, pala tjetër neutrale, sekretari i gjykatës, Sekretari i Përgjithshëm, Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm, Bordi dhe anëtarët e tij, si dhe Dhoma Ekonomike Federale e Austrisë dhe punonjësit e saj përjashtohen nga përgjegjësia për çdo veprim ose mosveprim në lidhje me procedurat, përveç nëse një veprim ose mosveprim i tillë përbën shkelje me dashje ose nga pakujdesia e rëndë.

SHTOJCA 5

VIAC SI AUTORITETI ADMINISTRUES

VIAC mund të caktohet për të vepruar si autoriteti administrues në procedurat ad hoc.

VIAC SI AUTORITETI ADMINISTRUES

Neni 1

(1) Në arbitrazhet që rregullohen nga Rregullat e Arbitrazhit të UNCITRAL ose arbitrazhet e tjera ad hoc ose procedurat e tjera ad hoc për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve, VIAC vepron si autoriteti administrues në përputhje me Shtojcën 5 nëse palët kanë rënë dakord që procedura do të administrohet nga VIAC.

(2) VIAC mund të ofrojë shërbimet administrative të mëposhtme:

2.1 Shërbime mbështetëse, duke përfshirë

- i. mbajtjen e dosjes për komunikimet dhe kërkesat me shkrim;
- ii. lehtësimin e komunikimeve, duke mundësuar zgjedhjen e aksesit në Platformën e VIAC (“Portali i VIAC”);
- iii. marrëveshjet për zhvillimin e mbledhjeve dhe seancave:
 - duke asistuar në caktimin e datës, orës dhe vendit të mbledhjes dhe seancave;
 - duke organizuar sallat e mbledhjeve/të seancave në ambientet e Dhomës Ekonomike Federale të Austrisë, duke përfshirë pajisjet teknike dhe mbështetjen logjistike;
 - duke organizuar drekat zyrtare dhe shërbimet e kateringut në ambientet e brendshme;
 - duke asistuar me organizimin e logjistikës, p.sh. identifikimin dhe angazhimin e reporterëve dhe interpretuesve të gjykatës;

– duke lehtësuar vizat e hyrjes kur kërkohet;

iv. shërbimet në lidhje me ruajtjen e dosjeve, duke përfshirë vendimet e arbitrazhit.

2.2 Administrimin e shpenzimeve, duke përfshirë mbajtjen e depozitave nga palët si paradhënie mbi shpenzimet e procedurës dhe trajtimin e pagesave për arbitrat dhe ofruesit e shërbimeve.

2.3 Shërbimet si autoriteti caktues siç përshkruhet në Nenin 1 të Shtojcës 4.

KËRKESA

Neni 2

(1) Një kërkesë duhet t'i dorëzohet VIAC në përputhje me Nenin 12 të Rregullave të Vjenës dhe duhet të jetë:

1.1 me shkrim në një nga gjuhët e korespondencës së VIAC (anglisht ose gjermanisht);

1.2 me datë;

1.3 e nënshkruar nga pala/palët kërkuese ose përfaqësuesi(ët) e saj/tyre të autorizuar rregullisht. Nëse kërkesa është nënshkruar nga një përfaqësues, ajo duhet të ketë bashkëlidhur vërtetimin e autorizimit, p.sh. një prokurë ose marrëveshje bashkëpunimi.

(2) Sekretari i Përgjithshëm mund të kërkojë informacion shtesë në varësi të shërbimeve të kërkuara.

SHPENZIMET

Neni 3

(1) Nëse VIAC kërkohet që të veprojë si autoriteti administrues sipas Nenit 1 të Shtojcës 5, pala(ët) kërkuese do të paguajnë një tarifë regjistrimi neto në shumën e parashikuar në Shtojcën 3. Tarifa e regjistrimit është e pakthyeshme dhe nuk do të zbritet nga parapagimi për shpenzimet e palës paguese. Një kërkesë do të trajtohet vetëm pasi tarifa e regjistrimit të paguhet plotësisht.

(2) Në varësi të shërbimeve administrative të kërkuara, do të zbatohen tarifat administrative të mëposhtme:

2.1 Për shërbimet e plota administrative, VIAC do të vendosë tarifat e saj standarde administrative sipas Shtojcës 3 në varësi të shumës në mosmarrëveshje. Shuma në mosmarrëveshje do të llogaritet bazuar në dispozitat e shpenzimeve të Rregullave të Vjenës ose Rregullave të Ndërmjetësimit të Vjenës, në varësi të natyrës së mosmarrëveshjes.

2.2 Për shërbimet e zgjedhura administrative, VIAC do të reduktojë tarifat e saj administrative sipas rastit.

2.3 Në parim, shërbimet e VIAC si autoritet administrativ ndahen në tre kategori. Për secilën kategori, do të paguhet një e treta e tarifave standarde sipas Shtojcës 3, në varësi të shumës në mosmarrëveshje:

i.shërbimet mbështetëse siç përshkruhet në Nenin 1 paragrafi 2.1 i Shtojcës 5;

ii.shërbimet si administrator për shpenzimet e përshkruara në Nenin 1 paragrafi 2.2 i Shtojcës 5;

iii.shërbimet si autoritet caktues siç përshkruhet në Nenin 1 paragrafi 2 i Shtojcës 4.

2.4 Në çdo rast, tarifat administrative minimale do të jenë 3,000 Euro.

(3) PAGESA PARAPRAKE E SHPENZIMEVE PËR TARI FAT ADMINISTRATIVE DUHET TË KRYHET PLOTËSISHT PËRPARA SE VIAC TË O FROJË SHËRBIMET PËRKATËSE.

(4) Të gjitha pagesat paraprake të shpenzimeve në një procedurë arbitrazhi do t'i nënshtrohen dispozitave për pagesat paraprake për shpenzimet sipas Rregullave të Arbitrazhit të VIAC (Neni 42), ose kur shërbimet e administrimit kërkojnë në procedurat e tjera të zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve, ato do t'i nënshtrohen Rregullave të Ndërmjetësimit të VIAC (Neni 8). Të gjitha pagesat paraprake për shpenzimet mund të tërhiqen nga VIAC në çdo fazë gjatë ose pas procedurës, për të mbuluar shpenzimet e kryera në lidhje me këtë procedurë. Fondet do të disbursohen vetëm sipas urdhrit të gjykatës së arbitrazhit, ose në

rastin e procedurave të tjera ad hoc të zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve, të personit të tretë neutral.

(5) Në rrethana të veçanta, VIAC mund të shmangë shumat e përcaktuara në paragrafin 2 të këtij Neni.

KUFIZIMI I PËRGJEGJËSISË

Neni 4

Arbitri, pala tjetër neutrale, sekretari i gjykatës, Sekretari i Përgjithshëm, Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm, Bordit dhe anëtarët e tij, si dhe Dhoma Ekonomike Federale të Austrisë dhe punonjësit e saj përjashtohen nga përgjegjësia për çdo veprim ose mosveprim në lidhje me procedurat, përveç nëse një veprim ose mosveprim i tillë përbën shkelje me dashje ose nga pakujdesia e rëndë.

SHTOJCA 6

RREGULLAT PLOTËSUERE PËR MOSMARRËVESHJET NË LIDHJE ME TRASHËGIMINË

Rregullat plotësuese për mosmarrëveshjet në lidhje me trashëgiminë të përcaktuara në Shtojcën 6 do të zbatohen nëse palët kanë rënë dakord për zbatimin e tyre, ose nëse kërkesa është parashikuar nga trashëgimlënësi në disponimin e pasurisë pas vdekjes, duke përfshirë një marrëveshje për trashëgiminë, ose në çdo akt tjetër juridik që nuk bazohet në marrëveshjen e palëve.

VIAC DHE VERSIONI I ZBATUESHËM I RREGULLAVE TË VJENËS

Neni 1

*Paragrafi 1 i Neni 1 të Rregullave të Vjenës është **plotësuar me shitesën e mëposhtme:***

(1) Qendra Ndërkombëtare e Arbitrazhit në Vjenë (“VIAC”) është Institucioni i Përhershëm Ndërkombëtar i Arbitrazhit i Dhomës Ekonomike Federale të Austrisë¹. VIAC administron arbitrazhet kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe procedurat në përputhje me metodat e tjera të zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve, nëse palët kanë rënë dakord për Rregullat e Arbitrazhit të VIAC (“Rregullat e Vjenës”), Rregullat e Ndërmjetësimit të VIAC (“Rregullat e Ndërmjetësimit të Vjenës”), Rregullat e Arbitrazhit të Investimeve të VIAC (“Rregullat e Arbitrazhit të Investimeve të Vjenës”), Rregullat e Ndërmjetësimit të Investimeve të VIAC (“Rregullat e Ndërmjetësimit të Investimeve të Vjenës”); ose nëse është rënë dakord ose parashikuar ndryshe që VIAC duhet të shërbejë si institucion administrues. **Kjo përfshin rastet kur administrimi nga VIAC është parashikuar nga trashëgimlënësi në disponimin e pasurisë pas vdekjes, duke përfshirë një marrëveshje për trashëgiminë, ose në çdo akt tjetër juridik që nuk bazohet në një marrëveshje të palëve.**

*Paragrafi 2 i Neni 1 të Rregullave të Vjenës është **zëvendësuar me ndryshimin e mëposhtëm:***

¹ Sipas Seksionit 139, paragrafi 2 i Statutit Federal të Dhomave Ekonomike 1998 (“Wirtschaftskammergesetz 1998”), Fletore Zyrtare Federale I Nr. 103/1998, të ndryshuar me Fletoren Zyrtare Federale I Nr. 27/2021

(2) Përveç kur është rënë dakord ose parashikuar ndryshe në disponimin e pasurisë pas vdekjes, Rregullat e Vjenës do të zbatohen në mosmarrëveshjet në lidhje me trashëgiminë në versionin e zbatueshëm në kohën e fillimit të procedurës së arbitrazhit (Neni 7, paragrafi 1).

BASHKIMI I KËRKIMEVE

Neni 15

Paragrafi 1 i Nenit 15 të Rregullave të Vjenës është zëvendësuar nga paragrafi 1 dhe plotësuar nga paragrafi 3 si më poshtë:

(1) Me kërkesën e njëres prej palëve, dy ose më shumë procedura arbitrazhi në mosmarrëveshjet në lidhje me trashëgiminë mund të bashkohen nëse:

1.1 palët bien dakord për bashkimin; ose

1.2. i njëjti arbitër(a) është/janë emëruar ose caktuar; ose

1.3. pretendimet janë të lidhura ligjërisht ose faktikisht, dhe palët në procedurën e arbitrazhit janë të paktën pjesërisht të njëjta;

dhe vendi i arbitrazhit është i njëjtë.

(2) I pandryshuar.

(3) (i ri) Nëse një palë kërkon bashkimin përpara emërimit ose caktimit të arbitrit(ave) dhe nëse një bashkim i tillë miratohet nga Bordi, formimi i gjykatës së arbitrazhit do të rregullohet nga Neni 18. Nëse një arbitër është emëruar ose caktuar paraprakisht, procedura e arbitrazhit do të bashkohet me arbitrazhin e parë, përveç nëse palët kanë rënë dakord ndryshe. Në këtë rast, Bordi mund të anulojë caktimet e bëra dhe të caktojë bashkë-arbitra të rinj ose të gjithë arbitrat në përputhje me Nenin 18.

GJYKATA E ARBITRAZHIT – DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 16

Paragrafi 1 i Nenit 16 të Rregullave të Vjenës është plotësuar nga shtesa e mëposhtme:

(1) Palët ose trashëgimlënësi janë të lirë të caktojnë personat që dëshirojnë të emërojnë si arbitra. Çdo person me zotësi të plotë juridike mund të veprojë si arbitër, me kusht që palët të mos kenë rënë dakord, ose trashëgimlënësi të mos ketë parashikuar në disponimin e pasurisë pas vdekjes, ndonjë kërkesë të veçantë shtesë për kualifikimin. Arbitrat kanë një marrëdhënie kontraktuale me palët dhe do t'u ofrojnë shërbimet e tyre palëve.

FORMIMI I GJYKATËS SË ARBITRAZHIT

Neni 17

Paragrafët 1 dhe 2 të Nenit 17 të Rregullave të Vjenës janë plotësuar nga shtesat e mëposhtme:

(1) Palët mund të bien dakord, ose trashëgimlënësi mund të parashikojë në disponimin e pasurisë pas vdekjes, nëse procedura e arbitrazhit do të zhvillohet nga një arbitër i vetëm ose një trup gjykues i përbërë nga tre arbitra. Palët gjithashtu mund të bien dakord, ose trashëgimlënësi mund të parashikojë në disponimin e pasurisë pas vdekjes, mënyrën e caktimit të arbitrave. Në mungesë të një marrëveshjeje ose disponimi të pasurisë pas vdekjes, do të zbatohen paragrafët 2 dhe 6 të këtij Neni.

(2) Në mungesë të marrëveshjes ose disponimit të pasurisë pas vdekjes për numrin e arbitrave, Bordi do të vendosë nëse mosmarrëveshja do të zgjidhet nga një arbitër i vetëm ose një trup gjykues i përbërë nga tre arbitra. Në këtë mënyrë, Bordi do të marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, shumën në mosmarrëveshje, dhe interesin e palëve në marrjen e një vendimi të shpejtë dhe me shpenzime efektive.

VENDI I ARBITRAZHIT

Neni 25

Paragrafi 1 i Nenit 25 të Rregullave të Vjenës është plotësuar nga shtesat e mëposhtme:

(1) Palët janë të lira të bien dakord për, ose trashëgimlënësi është i lirë të parashikojë, vendin e arbitrazhit. Në mungesë të marrëveshjes së palëve ose disponimit të pasurisë pas vdekjes, vendi i arbitrazhit do të jetë Vjena.

GJUHA E PROCEDURËS

Neni 26

*Neni 26 i Rregullave të Vjenës është **plotësuar** nga **shtesat** e mëposhtme:*

Në mungesë të marrëveshjes së palëve ose **disponimit të pasurisë pas vdekjes** për gjuhën(ët) e arbitrazhit, menjëherë pas dërgimit të dosjes, gjykata e **arbitrazhit do të vendosë gjuhën(ët) duke patur parasysh të gjitha rrethanat, duke përfshirë gjuhën e kontratës ose disponimit të pasurisë pas vdekjes.**

LIGJI I ZBATUESHËM, AMIABLE COMPOSITEUR

Neni 27

*Paragrafët 1 dhe 2 të Nenit 27 të Rregullave të Vjenës janë **zëvendësuar** nga **paragrafi 1** më poshtë:*

- (1) Ligji i zbatueshëm për mosmarrëveshjet në lidhje me trashëgiminë do të jetë ligji i zbatueshëm sipas rregullave të konfliktit të ligjeve të vendbanimit të personit në kohën e vdekjes ose ligji që mund të zgjidhet sipas tij.
- (2) Fshirë.